

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Lënda Nr. P 84/14 (PPS 67/10)

Data: 29 maj 2014

AKTVENDIM

LIDHUR ME KUNDËRSHTIMET NDAJ PROVAVE

DHE KËRKESAT PËR HUDHJEN E AKTAKUZËS

Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska - Gallant, duke vepruar si kryetare e trupit gjykues, në lëndën penale kundër të pandehurve:

1. **F.L.**
2. **S.T.**
3. **N.K.**
4. **A.A.**
5. **B.D.**

Të akuzuar për këto vepra penale:

1. **Krimi i organizuar**, në shkelje të nenit 274, paragrafit 3 të KPK-së (kodit të vjetër) lexuar me paragrafin 1 të KPK-së dhe lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së (kodit të vjetër) (bashkë-kryerja) sa i përket F.L., N.K. dhe S.T.;
2. **Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës**, në shkelje të nenit 340, paragrafëve 1 dhe 3 të KPK-së (kodit të vjetër) lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së (kodit të vjetër) (bashkë-kryerja) sa i përket F.L. dhe N.K.; dhe më tej lexuar së bashku me nenin 25 të KPK-së (kodit të vjetër) (ndihma) sa i përket S.T.;

3. **Lidhja e kontratës së dëmshme**, në shkelje të nenit 237 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së (kodit të vjetër) lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së (kodit të vjetër) (bashkë-kryerja) sa i përket F.L. dhe N.K., dhe më tej lexuar së bashku me nenin 25 të KPK-së (kodit të vjetër) (ndihma) sa i përket S.T.;
4. **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**, në shkelje të nenit 422 paragrafit 1 të KPK-së lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së (kodit të vjetër) (bashkë-kryerja) sa i përket F.L. dhe N.K.; dhe lexuar së bashku me nenin 25 të KPK-së (kodit të vjetër) (ndihma) sa i përket S.T.; dhe përveç kësaj lexuar së bashku me nenin 117.1.a. dhe d. të Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe si shtesë lexuar së bashku me veprën penale të Marrjes së rryshfetit, siç është specifikuar në Pikën 5;
5. **Marrja e rryshfetit**, në shkelje të nenit 343, paragrafit 2 të të KPK-së (kodit të vjetër) lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së (kodit të vjetër) (bashkë-kryerja) sa i përket F.L. dhe S.T.; dhe lexuar së bashku me nenin 25 të KPK-së (kodit të vjetër) (ndihma) sa i përket N.K.; dhe përveç kësaj lexuar së bashku me nenin 117.1.a. dhe d. të Ligjit mbi Prokurimin Publik;
6. **Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi**, në shkelje të nenit 236 paragrafit 1 nën-paragrafëve 4 dhe 5, dhe paragrafit 2 të KPK-së (kodit të vjetër) lexuar së bashku me nenin 117.1.a. dhe d. të Ligjit mbi Prokurimin Publik, si dhe veprën penale të **Dhënies së rryshfetit**, në shkelje të nenit 344, paragrafit 1 të KPK-së (kodit të vjetër); të gjitha të lexuara së bashku me nenin 25 të KPK-së (kodit të vjetër) (ndihma) sa i përket A.A.t dhe B.D.;

pas marrjes së Aktakuzës PPS nr. 67/10 parashtruar nga Prokurori Special Johannes Pickert (“Prokurori” ose “Prokurori Special”), si përfaqësues i Prokurorisë Speciale të Kosovës (“PSRK”), më 18 shkurt 2014 kundër të pandehurve të lartpërmendur për akuzat e lartpërmendura;

pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar mbi Aktakuzën, më datën 26 mars 2014 në praninë e palëve, në pajtim me nenin 245 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (Ligji Penal nr. 04/L-123, tutje referuar si “KPP”);

duke patur parasysh se palët kanë të drejtë të paraqesin propozime sipas nenit 245 (5), nenit 249 dhe nenit 250 të KPP-së, dhe ata kanë vepruar ashtu në përputhje me rrethanat;

duke patur parasysh se Prokurori ka paraqitur me kohë një përgjigje ndaj kundërshtimeve sipas nenit 251 të KPP-së;

në pajtim me nenet 249, 250, 253 dhe 254 të KPP-së,

lëshon si në vijim:

AKTVENDIM

- I. Kundërshtimet ndaj Provave, të paraqitura nga avokati mbrojtës, Tahir Rrecaj, në emër të të pandehurit F.L., më datën 24 prill 2014, nga avokati mbrojtës, Bajram Tmava, në emër të të pandehurit N.K. dhe nga N.K. personalisht, më datën 23 prill 2014, nga avokati mbrojtës Artan Qerkini, në emër të të pandehurit S.T. më datën 18 prill 2014 dhe nga avokati mbrojtës Qerim Metaj, në emër të të pandehurit B.D., më datën 11 prill 2014 janë pjesërisht të bazuara, dhe provat e mëposhtme konsiderohen të papranueshme dhe do të përjashtohen nga shkresat e lëndës dhe do të mbyllen:
- deklaratat në procedurë paraprake të dëshmitarëve dhe të pandehurve në vijim:
 - i. deklaratat e dëshmitarit I.M. e datës 12 janar 2012;
 - ii. deklaratat e dëshmitarit Xh.R. e datës 6 dhjetor 2010;
 - iii. deklaratat e dëshmitarit H.D. e datës 18 mars 2013;
 - iv. deklarata e të pandehurit A.A., e datës 15 mars 2013;
 - v. deklarata e të pandehurit B.D., e datës 14 mars 2013
 - mendimi i ekspertit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë;
 - padia e paraqitur nga paditësi Azem Hysen Mazreku në Gjykatën Komunale të Malishevës për vërtetimin e së drejtës së pronësisë në pronë të paluajtshme, të datës 4 korrik 2007;
- II. Kryetarja e trupit gjykues, duke vepruar *sipas detyrës zyrtare*, të gjitha provat e mbledhura pas datës 6 prill 2008 në zbatim të “Urdhërit për kërkesën për masa të fshehta”, lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës (PPN 697-7/07) më 6 shkurt 2008, i shpalli të papranueshme. Këto prova do të përjashtohen nga shkresat e lëndës dhe do të mbyllen.
- III. Kërkesat për hudhje të aktakuzës, paraqitur nga avokati mbrojtës, Tahir Rrecaj, në emër të të pandehurit F.L. më datën 24 prill 2014, nga avokati mbrojtës, Bajram Tmava, në emër të të pandehurit N.K. dhe nga N.K. personalisht, më datën 23 prill 2014, nga avokati mbrojtës Artan Qerkini, në emër të të pandehurit S.T. më datën 18 prill 2014 dhe nga avokati mbrojtës Qerim Metaj, në emër të të pandehurit B.D., më datën 11 prill 2014, miratohen pjesërisht. Hudhen pikat e aktakuzës të cekura në vijim dhe procedura penale për akuzat përkatëse përfundohet:

- Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 2);
- Lidhja e kontratës së dëmshme kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 3);
- Marrja e ryshfetit kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 5)
- Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi dhe Dhënia e ryshfetit kundër A.A.t dhe B.D. (Pika 6).

ARSYETIM

I. Historiku procedural

1. Më 8 gusht 2012, Prokuroria lëshoi një Aktvendim mbi fillimin e hetimeve duke hapur rastin PPS 79/12 kundër të pandehurve të përmendur më lart si dhe për personat në vijim për kryerjen e veprave penale të Krimit të organizuar, Lidhjes së kontratës së dëmshme, Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, Keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi dhe Marrjes dhe Dhënies së ryshfetit.
2. Më 15 tetor 2012, Prokuroria zgjeroi rastin PPS 79/12 kundër F.L. dhe N.K. për veprën penale të Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës. Në të njëjtën ditë, Prokuroria i bashkoi rastet PPS 19/11 me PPS 79/12 dhe pastaj e bashkoi rastin PPS 79/12 me rastin PPS 67/10, duke i bashkuar të gjitha hetimet nën emërtimin e rastit PPS 67/10 duke qenë kështu rasti kryesor sepse ishte filluar i pari.
3. Më 18 shkurt 2014, Aktakuza PPS 67/10 është parashtruar nga Prokuroria në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër të pandehurve të lartpërmendur dhe për akuzat e përmendura më lart. Prokurori Special i siguroi Gjykatës shkresat origjinale të lëndës së bashku me kopjet elektronike që më pastaj janë dorëzuar nga administrata e Gjykatës Themelore tek të pandehurit dhe avokatët mbrojtës përkatës.
4. Shqyrtimi fillestar u mbajt më 26 mars 2014 në praninë e palëve. Aktakuza është lexuar dhe të pandehurit u deklaruan jo-fajtorë në të gjitha pikat e aktakuzës.
5. Në pajtim me nenin 245 (5) të KPP-së, kryetarja e trupit gjykues, gjatë shqyrtimit fillestar, kërkoi që mbrojtja të paraqesë parashtresat me shkrim brenda 30 ditëve.
6. Deri më 25 prill 2014, avokatët mbrojtës të F.L., S.T., N.K. dhe B.D., si dhe vet N.K., në pajtim me nenet 245 (5), 249 dhe 250 të KPK-së, paraqiten kundërshtimet ndaj provave dhe kërkuan hudhjen e aktakuzës. I pandehuri A.A., deri më tani duke vepruar *pro se* gjatë procedurave penale, nuk paraqiti një kërkesë.
7. Prokurorit të PSRK-së iu dorëzuan parashtresat e mbrojtjes më datën 30 prill 2014 dhe përgjigjet me shkrim të parashtruara më 7 maj 2014, dmth brenda një periudhe kohore prej një jave të paraparë me nenin 251 (3) të KPP-së.

II. Ligji procedural i zbatueshëm

8. Meqenëse gjatë procedurës penale kundër të pandehurve, ligji material dhe procedural ishte objekt i ndryshimeve themelore, Kryetarja e Trupit Gjykes e konsideron të nevojshme që, para se të futet në thelbin e çështjes, të vlerësojë ligjin e zbatueshëm si çështje paraprake.
9. Me KPP-në në fuqi, që nga 1 janari 2013, ligji procedural ka ndryshuar rrënjësisht. Në bazë të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të vitit 2004 ("KPPK") të UNMIK-ut, procedura ishte më shumë e orientuar nga e drejta kontinentale, ndërsa kodi i ri përfshiu aspekte kundërshtuese në procedurë. Për lëndën në fjalë, pyetjet themelore lidhur me ligjin e zbatueshëm janë, nëse procedura para Gjykatës (aktakuza dhe faza e deklarimit rreth fajësisë, shqyrtimi gjyqësor dhe faza e mjetit ligjor) do të rregullohen nga KPP apo nga KPPK. Po kështu, është vendimtare të përcaktohet se cilat dispozita duhet të zbatohen nga Gjykata për të vlerësuar pranueshmërinë e provave të siguruara gjatë hetimit të kryer në bazë të Kodit të mëparshëm.
10. Kryetarja e Trupit Gjykes gjen se situata procedurale e rastit aktual mbulohet nga dispozita kalimtare e nenit 540 të KPP-së, që lexon si në vijim:

"Dispozitat e këtij Kodi zbatohen përshtatshëm për çdo procedurë penale të filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi në të cilën nuk është ngritur aktakuzë".

Procedura penale në rastin në fjalë është filluar me aktvendimin mbi fillimin e hetimeve, më datën 8 gusht 2012, pra para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale. Aktakuza PPS 67/10 është ngritur më 19 shkurt 2014, që është më shumë se një vit pas hyrjes në fuqi të KPP-së. Pra, KPP është kodi procedural i aplikueshëm, sipas nenit 540 të KPP-së.

III. **Kundërshtimet ndaj provave**

1. **Komente të përgjithshme**

11. Qëllimi i shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë, të parashikuar nga KPP, është të eliminohen lëndët që vërtet nuk kanë meritë, dhe të mbrohen të pandehurit nga ekspozimi i pajustificuar dhe potencialisht i gjatë në shqyrtimin gjyqësor. Në kundërshtim me KPPK-në, sipas strukturës ligjore të KPP-së, gjykata nuk ka më të drejtë të vlerësojë plotësisht Aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave duke vepruar sipas detyrës zyrtare. Kundërshtimet kundër provave dhe/ose kërkesat për hudhjen e aktakuzës duhet të

paraqiten nga Mbrojtja në bazë të neneve 249 dhe 250 të KPP-së. Prokurori ka mundësinë t'u përgjigjet këtyre kundërshtimeve dhe/ose kërkesave, siç parashikohet në nenin 251. Argumentet e ngritura nga të dyja palët shqyrtohen nga Kryetari i Trupit Gjykses, me qëllim që të bëjë vlerësimet përkatëse.

12. Në bazë të nenit 249 (1) të KPP-së, të pandehurit mund të paraqesin kundërshtime ndaj provave të renditura në Aktakuzë, bazuar në këto arsye:
 - provat nuk u siguruan në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit, ose subjektet e tjera shtetërore;
 - provat shkelin rregullat në Kapitullin XVI të këtij Kodi;
 - ka një arsye të artikulueshme që Gjykata t'i gjejë provat thelbësisht të pambështetshme
13. Në bazë të nenit 249 (5) të KPP-së, e vetmja kompetencë e mbetur sipas detyrës zyrtare e Gjykatës në bazë të KPP-së është të përcaktojë nëse pranimi i provave do të shkelte të drejtat që i janë garantuar të pandehurit nga Kushtetuta e Kosovës (gjithashtu neni 97 (4) i KPP-së).
14. Në pajtim me rregullën e përgjithshme të mishëruar në nenin 257 (2) të KPP-së, provat e siguruara në shkelje të dispozitave të procedurës penale do të jenë të papranueshme kur Kodi i tanishëm ose dispozita të tjera ligjore e parashikojnë këtë shprehimisht. Ky rregull është zhvilluar në paragrafin 3 të këtij neni, që shpall se Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme. Pikërisht të njëjtat dispozita u përfshinë në nenin 153 të KPPK-së.
15. Sa i përket ligjit procedural të zbatueshëm për përcaktimin e pranueshmërisë së provave, ia vlen t'i bëhet referencë Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN 577/2013, të datës 10 dhjetor 2013. Gjykata ka paraqitur një qasje dy nivelëshe duke i kërkuar Kryetares së Trupit Gjykses të vlerësojë në hapin e parë nëse veprimet hetimore janë kryer në mënyrë të ligjshme dhe, në hapin e dytë, të vlerësojë nëse provat e marra janë të pranueshme dhe mund të përdoren si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pjesa e parë e vlerësimit do të duhet gjithmonë të përcaktohet kundër rregullave procedurale në fuqi në kohën kur është kryer veprimi hetimor, ndërsa si rregull e përgjithshme, vlerësimi i pranueshmërisë do të bëhet në bazë të klauzolave të pranueshmërisë të diktuar nga KPP, sa i përket Kodit të zbatueshëm ndaj

procedurës penale si tërësi. Vetëm përjashtimisht klauzolat e pranueshmërisë të KPPK-së do të mund të mbeten të zbatueshme.

2. Prova qartazi të parëndësishme (Parashtresë e mbrojtjes së F.L.t)

Parashtresë e palëve

16. Mbrojtja parashtron se provat në vijim janë qartazi të parëndësishme, pra të papranueshme, në pajtim me nenin 249 (1.2) lexuar së bashku me nenin 259 (1) të KPP-së:

- deklarata e dëshmitarit I.M., e datës 12 janar 2012¹;
- deklarata e dëshmitarit Xh.R. e datës 6 dhjetor 2010²;
- raporti i ekspertit nga eksperti i gjeodezisë³;
- deklarata e Q.K. e datës 7 korrik 2007;
- padia e paraqitur nga paditësi A.H.M. e datës 4 korrik 2007⁴;

17. Prokuroria paraqet se kundërshtimi duhet të refuzohet pasi që provat e mësipërme janë të një vlere të fortë provuese dhe i referohen rrethanave personale të të pandehurit S.T. Më tej, për të ruajtur plotësinë e shkresave të lëndës dhe transparencën e procedurës, të gjitha provat e mbledhura gjatë fazës hetimore, ndjekur fillimisht ndaras dhe pastaj bashkuar në një rast, i janë dorëzuar Gjykatës.

Ligji i zbatueshëm

18. Ligji 259 (1) i KPP-së përcakton se provë qartazi e parëndësishme është cilado provë që nuk ka të bëjë me: të provuarit e ndonjë elementi të veprës penale (i); dëmit të shkaktuar me vepër penale (ii); mbrojtjes nga ndjekja (iii); apo ndonjë çështje tjetër të rëndësishme (iv). Brenda kontekstit të nenit 259 (1) të KPP-së, “çështja” duhet të interpretohet si një çështje që ka të bëjë me rastin. Definicioni substancial i “relevancës” në aspektin e provave është diskutuar në jurisprudencë të gjykatave dhe tribunaleve ndërkombëtare.⁵ Për shembull,

¹ Dosja 6, pp. 58 et seq.

² Dosja 6, pp. 100 et seq.

³ Dosja 1, pp. 126 et seq.

⁴ Dosja 1, pp. 112 et seq.

⁵ ICC, *Prokurori v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, Versioni i hartuar Publik, i Vendimit të Parë mbi Kërkesat e Prokurorisë dhe Mbrojtjes për pranimin e provave, i datës 15 dhjetor 2011, ICC-01/05-01/08-2012-Red, para. 14.

Gjykata Penale Ndërkombëtare (GjPN) ka përcaktuar relevancën që ka të bëjë me “çështjet që duhet të merren parasysh nga Gjykata në hetimin e saj të akuzave kundër të akuzuarve” dhe se “një gjë do të jetë relevante vetëm nëse ka potencial për të ndikuar në përcaktimin e Gjykatës në së paku një fakt, që ka nevojë të përcaktohet për të zgjidhur rastin”.⁶ Kryetari i trupit gjykues e konsideron këtë qasje të arsyeshme dhe do të miratohet për vlerësimin ligjor të kundërshtimit në fjalë.

Të gjeturat e Kryetarit të trupit gjykues

19. Deklarata e Qemajl Kadirit nuk ka mundur të gjendej në shkresat e lëndës të dorëzuara në Gjykatë dhe, prandaj Gjykata nuk është në gjendje të vlerësojë përmbajtjen e saj dhe të lëshojë një vendim mbi pranueshmërinë e saj në prova.
20. Sa i përket provave tjera në fjalë, ato kanë të bëjnë me një pronë të paluajtshme (ngastër toke) dhe një padi të paraqitur nga A.H.M. në Gjykatën Komunale të Malishevës për konfirmim të së drejtës së pronësisë në një ngastër të tillë. Në lidhje me procesverbalin e dëgjimit të Ismet Mazrekut para PK-së, mbajtur më 12 janar 2012, megjithëse Prokuroria argumenton se është e vlerës së fortë provuese në lidhje me akuzat kundër S.T., e vetmja informatë që ka të bëjë me rastin aktual është fakti që dëshmitari ka deklaruar se S.T. ka qenë ose shoferi ose roja personale e F.L. Fakti se S.T. është roja personale e F.L. nuk diskutohet nga palët. Prandaj, kjo çështje duhet të konsiderohet jo relevante me rastin pasi që nuk ka potencial për të përcaktuar ndonjë fakt në këtë rast dhe nuk përmbush ndonjë nga kushtet e parapara në nenin 259 (1) të KPP-së.
21. Pjesa tjetër e provave e kundërshtuar nga mbrojtja (dmth, deklaratat e XH.R. e datës 6 dhjetor 2010, raporti i ekspertit nga eksperti i gjeodezisë, dhe padia e paraqitur nga A.H.M. e datës 4 korrik 2007) mbulojnë aspektet e ngastrës së kontestuar të përmendur më lart. Asnjë informatë që do të mund të ishte relevante për rastin sipas nenit 259 (1) të KPP-së nuk është gjetur në këto dokumente. Si rezultat, nuk përmbushet asnjëri nga kushtet e paraqitura më lart dhe, prandaj, Kryetarja e Trupit Gjykues i konsideron ato jorelevante dhe nuk i pranon ato në prova.

Shih gjithashtu ICTY, *Prokurori v. Mucic et al.*, Vendimi mbi Propozimin e Prokurorisë për Pranueshmërinë e Provave, 19 janar 1998, IT-96-21.

⁶ Ibid.

22. Pra, Kryetarja e Trupit Gjykes i konsideron të papranueshme provat në vijim për shkak se ato janë qartazi të parëndësishme:

- dëshmitë e I.M.
- deklarata e XH.R. e datës 6 dhjetor 2010,
- ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë,
- padia e paraqitur nga A.H.M. e datës 4 korrik 2007

3. Provat e marra përmes Urdhërit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës (PPN 697-7/07), të datës 6 shkurt 2008 (Mbrojtja e F.L. e S.T. dhe B.D.)

Parashtrësat e palëve

23. Mbrojtja e F.L.t mendon se porositë tekstuale SMS të marra përmes urdhërit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (PPN 697-7/07), të datës 6 shkurt 2008 janë të papranueshme sipas nenit 249 (1.1) të KPP-së, lexuar së bashku me nenin 259 (1) të KPPK-së (neni 93 i KPP-së). Urdhëri i gjykatës i referohet një procedure tjetër penale (rastit të “Shpërthimit në Bulevardin Clinton” case) dhe nuk përmend asnjë nga të pandehurit në rastin aktual. Veç kësaj, përdorimi i këtyre provave do të shkelte të drejtën për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtëve të Njeriut dhe të Drejtave Themelore (tutje “KEDNj”). Mbrojtja nuk ka shqyrtuar më tej se për se këto dispozita të veçanta duhet të zbatohen për të arsyetuar konstatimin mbi jopranueshmërinë.

24. Kundërshtime të njejta janë ngritur nga mbrojtja e B.D., duke argumentuar se ai nuk ishte as i dyshuar e as subjekt i hetimeve dhe asnjë urdhër ligjor i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake për përgjimin e thirrjeve telefonike, dhe (ii) në mes të pandehurit A.A. dhe Z.A. pasiqë i pandehuri B.D. nuk ishte në dijeni të këtyre bisedave. Mbrojtja pohon se pranimi i këtyre gjërave në prova do të shkelte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

25. Gjithashtu mbrojtja e S.T. kundërshtoi provat e marra përmes urdhërit të përmendur më lart, sipas nenit 249 (1.1) të KPP-së lexuar së bashku me nenin 259 (1) të KPPK-së (neni 93 i KPP-së), për shkak se urdhëri nuk është lëshuar kundër të pandehurit i cili nuk ishte i dyshuar në procedurën penale PPN 697-7/07 (“Shpërthimi në Bulevardin Clinton”). Është

argumentuar se kjo situatë mbulohet nga nenet 259 (5) dhe 259 (6) nënparagrafi 2 i KPPK-së, sipas të cilit një urdhër i cili përfshin vetëm një përshkrim të përgjithshëm të telefonave, i cili mund të përgjohet “nuk duhet të përdoret për të përgjuar telekomunikimet e një personi i cili nuk është i dyshuar”. Tutje, mbrojtja paraqet se provat janë marrë në shkelje të KEDNj-së dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

26. Prokuroria, argumentet e ngritura nga mbrojtja, i konsideron si plotësisht të pabazuara në ligj dhe logjikë. Është paraqitur se asnjë dispozitë në KPPK, si ligji në fuqi në kohën kur është ekzekutuar masa e fshehtë, nuk lejon për përjashtimin e provave që dalin nga urdhëri i përgjimit, i cili është marrë dhe zbatuar në mënyrë të ligjshme, kundër një pale të dëgjuar të dëgjuar në përgjim, edhe nëse nuk i nështrohet urdhërit të përgjimit. Është argumentuar më tej se provat janë bazuar në bisedat me të pandehurin A.A., i cili i ishte nënshtruar urdhërit të përgjimit. Të drejtat kushtetuese nuk mund të përdoren si mburojë për të mbrojtur sjelljen kriminale.

Ligji i zbatueshëm

27. Pranueshmëria e provave të marra përmes urdhërit për masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, është rregulluar në nenin 97 të KPP-së, që në pjesë relevante parasheh:

“1. Prova e marrë nëpërmjet masës nga ky kapitull është e papranueshme nëse urdhëri për masën dhe zbatimin e saj është i kundërligjshëm.

2. Prova e cila është marrë nga (...) përgjimi i telekomunikimeve (...) lejohet vetëm në procedurë penale lidhur me veprën penale të përcaktuar në nenin 88 paragrafin 3 i këtij Kodi.(...)

4. Në çdo kohë para se aktgjykimi të merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të shqyrtojë pranueshmërinë e materialeve të mbledhura nga nenin 88 i këtij Kodi për shkelje të të drejtave kushtetuese të të pandehurit nëse ka indikacione se materilet janë mbledhur në mënyrë të kundërligjshme.”

28. Kryetarja e Trupit Gjykses gjen se pranueshmëria e provave të marra përmes masës së fshehtë të përgjimit, në parim, duhet të vlerësohet në bazë të dispozitave që i referohen mbrojtjes së privatësisë. Këto janë si në vijim:

Neni 8 i KEDNj:

“1. Çdokush ka të drejtë për respektimin e jetës së tij provate dhe familjare, të shtëpisë së tij dhe korrespondencës.

2. Nuk duhet të ketë kurrfarë ndërhyrje nga autoritetet publike në ushtrimin e kësaj të drejte përveç nëse në pajtim me ligjin, është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë komëbtare, sigurisë publike apo mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e një çrregullimi apo krimi, për mbrojtjen e shëndetit apo moralit, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

Neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

“1. Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera. (...)

3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.(...)”

Të gjeturat e Kryetares së Trupit Gjykses

29. Çështja në fjalë ka të bëjë me pranueshmërinë e provave të zbuluara “rastësisht” ose “aksidentalisht”, d.m.th. prova të marra papritur gjatë ekzekutimit të një mase të fshehtë të zbatuar në një procedurë tjetër penale, për një vepër dhe/se të dyshuar tjetër.

30. Pranueshmëria e provave të marra përmes një urdhëri për masa të fshehta dhe masa teknike të vëzhgimit dhe hetimit është rregulluar në nenin 97 të KPP-së. Kryetarja e Trupit Gjykses është e një mendjeje me Prokurorin se as neni 97 i KPP-së e as ndonjë dispozitë tjetër e KPP-së nuk arsyetojnë përjashtimin e provave të zbuluara rastësisht gjatë një urdhëri për përgjim të siguruar dhe zbatuar në mënyrë të ligjshme kundër një pale që nuk i

- nënshtrohet urdhërit. Kur një provë është marrë në mënyrë të ligjshme në një rast tjetër dhe ka mundur të merrej në mënyrë të ligjshme gjatë fazës hetimore të rastit aktual, ajo duhet të jetë e pranueshme.
31. Objekti dhe qëllimi i nenit 97 (2) të KPP-së është që të sigurohemi se kërkesat ligjore të nevojshme për urdhërimin e masave të fshehta ndërhyrëse specifike, nuk janë nënvlerësuar në rast se planifikohet që provat e marra në një procedurë tjetër penale të futen në një procedurë të ndarë penale. Prandaj, neni 97 (2) i KPP-së, në përgjithësi, nuk ndalon përdorimin e provave në një procedurë të ndarë penale por paraqet një kërkesë ligjore shtesë. Argumenti se neni 97 (2) i KPP-së duke përdorur termin “procedurë penale” mbulon situatën e një procedure tjetër penale, pasi që ajo nga e cila buron prova origjinale, mëshitet nga fakti se kërkesa e nenit 88 (3) e KPP-së është tanimë e mbuluar nga situatë e përmendur në nenin 97 (1) të KPP-së. Rasti aktual ka të bëjë me veprat penale të cekura në nenin 90 të KPP-së.
 32. Kryetarja e Trupit Gjykses vëren se neni 97 (2) i KPP-së kufizon mundësinë për të përdorur provat e marra përmes masës së fshehtë, vetm sa i përket objektit të procedurës penale, pasi që ai parasheh se është thjesht e pranushme në procedurë penale sa i përket një vepre penale, që është specifikuar në nenin 88 (3) të Kodit. Nuk ka kurrfarë kufizimi sa i përket një personi kundër të cilit mund të përdoret kjo provë, pasi që Kodi nuk përcakton, që prova është e pranueshme vetëm kundër personit kundër të cilit është aplikuar masa e fshehtë.
 33. Më tej, fakti se të pandehurit B.D. dhe S.T. nuk ishin në dijeni të bisedës në mes të A.A. dhe Z.A. është irelevant për pranimin e këtyre informatave në prova dhe/ose pranueshmërinë e tyre. Megjithatë, është bërë përjashtim ndaj telekomunikimeve të përgjuara nga data 5 prill 2008 deri më 4 qershor 2008, që janë marrë në mënyrë të paligjshme dhe, prandaj, nuk duhet të pranohen në prova, siç është sqaruar në një pjesë të mëtejme të arsytimit.
 34. Sa i përket argumentimit të ngritur nga avokati mbrojtës i F.L.se provat në fjalë nuk duhet të pranohen sepse do të shkelin të drejtën për një gjykim të drejtë, Kryetarja e Trupit Gjykses është plotësisht në dijeni se është një aspekt i kësaj të drejte që procedura penale duhet të jetë kundërshtuese dhe se duhet të ketë barazi të armëve në mes të prokurorisë dhe mbrojtjes. E drejta për një gjykim kundërshtues do të thotë, në një rast penal, ku edhe mbrojtjes e edhe prokurorisë duhet t’u jepet mundësia që të kenë njohuri dhe të komentojnë mbi vrojtimitet e paraqitura dhe provat e sjellura nga pala tjetër. Sidoqoftë,

Kryetarja e Trupit Gjykses është e mendimit se nuk është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë të F.L. sa i përket provave të marra përmes përgjimit, pasi që mbrojtja ka qasje në to dhe do të ketë mundësinë ta kundërshtojë besueshmërinë dhe relevancën e tyre ose rastin gjatë shqyrtimit gjyqësor.

35. Sa i përket argumenteve shtesë të paraqitura d.m.th. mos-përputhshmërisë së kodit të procedurës me KEDNj-në, Kryetarja e Trupit Gjykses i bënë referencë Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku Gjykata konsideron se legjislacioni i Kosovës në lidhje me masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit të përshkruara në Kapitullin XXIX të KPPK-së janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara nga KEDNj.⁷

3. Shqyrtimi sipas detyrës zyrtare nga Kryetarja e Trupit Gjykses sa i përket pranueshmërisë së provave të marra përmes përgjimit

36. Siç tanimë është përmendur më lart, sipas KPP-së Gjykata më nuk ka të drejtë që të vlerësojë plotësisht pranueshmërinë e provave sipas detyrës zyrtare. Kundërshtimet kundër provave duhet të paraqiten nga mbrojtja në pajtim me nenin 249 të KPP-së, në mënyrë që t'i mundësojnë Gjykatës të bëjë një vlerësim përkatës. E vetmja kompetencë e mbetur sipas detyrës zyrtare është në pajtim me nenin 249 (5) “të përcaktojnë nëse pranimi i provave do të shkelte të drejtat e garantuara për të pandehurin sipas Kushtetutës së Kosovës”. Në të njëjtën mënyrë, neni 97 (4) KPP parasheh – si një dispozitë *lex specialis* – se:

“Në çdo kohë para se aktgjykimi të merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm gjykses ose kryetari i trupit gjykses sipas detyrës zyrtare mund të shqyrtojë pranueshmërinë e materialeve të mbledhura nga nenin 88 i këtij Kodi për shkelje të të drejtave kushtetuese të të pandehurit nëse ka indikacione se materilet janë mbledhur në mënyrë të kundërligjshme.”

37. Kryetarja e Trupit Gjykses vëren se masa e fshehtë e përgjimit të telefonit të të pandehurit A.A. në rastin “Shpërthimi në Sheshin Clinton” ka ndodhur në vitin 2008 dhe, si rezultat, ligjshëmria e kësaj mase duhet të vlerësohet në pajtim me ligjin e aplikueshëm dhe që ishte në fuqi në vitin 2008, e që është, KPPK. Pyetja e ligjshmërisë e një mase të tillë sipas KPPK-së është udhëhequr nga nenet 256, 257 (3), 258 dhe 259 të KPPK-së. I një lidhjeje të veçantë

⁷ Shih Gjykata Supreme e Kosovës, Api-Kzi 1/2010, Aktgjykimi 26 nëntor 2010, fq. 13 et seq. (duke iu referuar KEDNj Rasti Bykov v. Russia, Kërkesa nr. 4378/02, Aktgjykimi 10 mars 2009).

- është neni 259 (1.4) i KPPK-së, që përshkruan se një urdhër për përgjim të telekomunikimeve duhet të specifikojë periudhën brenda së cilës do të kishte efekt urdhëri, që nuk duhet të tejkalojë gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e lëshimit të urdhërit.
38. Duhet të theksohet se kompetenca për të përgjuar komunikimin mbështet autoritete relevante shtetërore në funksionimin e tyre të hetimit dhe të zbulimit të krive dhe, si e tillë, është e nevojshme në një shoqëri demokratike për parandalimin e çrregullimit dhe krimit, brenda kuptimit të nenit 8 (2) të KEDNJ-së, që parasheh të drejtën për privatësi. Shtimi i krimit dhe në veçanti rritja e krimit të organizuar, shtimi i sofistikimit të kriminelëve kombinuar me lehtësinë dhe shpejtësinë e komunikimit çojnë në konkludim se përgjimi i telefonave është një mjet i domosdoshëm në luftën e krimit. Megjithatë, çdo masë hetimore ndërhyrëse duhet të bazohet në ligj dhe duhet të ekzekutohet brenda kufijve të caktuar nga ai.
39. Më 6 shkurt 2008, në rastin e “Shpërthimit në Bulevardin Clinton”, Gjykata e Qarkut të Prishtinës (PPN 697-7/07) lëshoi një urdhër për masa të fshehta të përgjimit të telekomunikimeve ndaj një numër personash, përfshirë të pandehurin A.A. (numri mobil 044-24-2255). Gjykata e Qarkut deklaroi qartë se “Urdhëri duhet të mbesë në fuqi për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditëve duke filluar nga data e lëshimit të tij”. Prandaj, është e qartë se masa do të ishte e ligjshme vetëm nga 6 shkurti 2008 deri më 5 prill 2008.
40. Prokuroria kërkon pranimin në prova të një numri të përgjimeve nga numri i telefonit të të pandehurit A.A.. Siç paraqitet në shkresa të lëndës, përgjimi i telekomunikimeve të A.A. shtrihet nga 9 shkurti 2008 deri më 4 qershor 2008. Përgjimi është dashur të bëhej nën rrethanat e favorshme të Urdhërit të lartpërmendur lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës, më 6 shkurt 2008. Është theksuar se Urdhëri do të skadonte më 5 prill 2008 dhe për tu konsideruar përgjimi ende i përshtatshëm, është dashur të jetë kërkuar vazhdimi i masës në bazë të nenit 261 të KPPK-së. Nuk ka asnjë provë në shkresa të lëndës se Urdhëri është vazhduar.
41. Ia vlen të theksohet se zyrtarët nga Njësia Hetimore Speciale ishin në dijeni të fuqisë ligjore të Urdhërit dhe datën e skadimit të tij më 5 prill 2008. Në një memorandum nga Hetuesi i NJHS-së, Sergio D’Orsi, drejtuar Prokurorit përgjegjës të rastit, më datën 21 mars 2008, Hetuesi thekson se po afrohej data e pushimit të urdhërit dhe se duhej të kërkohej një vazhdim. Në fakt, më 8 prill 2008, përmes një memorandum tjetër, Hetuesi i NJHS-së, Sven

- Ischen, informoi gjyqtarin nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës, i cili lëshoi urdhërin dhe prokurorin e këtij rasti se vlefshmëria e Urdhërit ishte gjashtëdhjetë (60) ditë dhe prandaj masat e fshehta pushojnë më 5 prill 2008.
42. Sidoqoftë, telefoni i të pandehurit A.A. është përgjuar gjithashtu dhe pas afatit të 5 prillit 2008. Përgjimi i telekomunikimeve që është bërë nga 6 prilli 2008 deri më 4 qershor 2008, prandaj, ishte i palishëm, pasi që ishte zbatuar pa një urdhër të ligjshëm që ka autorizuar masën dhe në shkelje të neneve 258 dhe 259 të KPPK-së.
43. Duke patur parasysh atë që u tha më lart, Kryetarja e trupit gjykues deklaroi *sipas detyrës zyrtare* se provat e marra nga telekomunikimet e përgjuara, nda data 6 prill 2008 deri më 1 qershor 2008 janë mbledhur në shkelje të të drejtave të të pandehurve të garantuara me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, Kryetarja e Trupit Gjykues refuzon pranimin e tyre në prova sipas nenit 249 (5) lexuar së bashku me nenin 97 (5) të KPP-së.

1. Pranueshmëria e marrjeve në pyetje dhe intervistave të të pandehurve dhe dëshmitarëve të kryera nga Zyrtari Ligjor i PSRK-së (Parashtresë e mbrojtjes së F.L.t)

Parashtresa e palëve

44. Mbrojtja pohon se deklaratat e të pandehurve dhe dëshmitarëve në vijim të cilat janë marrë nga Zyrtari Ligjor i PRKS-së, Bernhard Kuschnik, janë të papranueshme në pajtim me nenin 249 (1.1.) KPP, lexuar së bashku me nenin 51 (2) dhe 221 (4) të KPPK-së (neni 152 i KPP-së):
- Deklarata e të pandehurit S.T. e datës 19 mars 2013 ;
 - Deklarata e të pandehurit A.A., e datës 15 mars 2013 ;
 - Deklarata e të pandehurit B.D., e datës 14 mars 2013 ;
 - Deklarata e dëshmitarit H.D. e datës 18 mars 2013 ;
 - Deklarata e dëshmitarit I.M. e datës 12 janar 2012
45. Prokurori paraqet se të gjitha marrjet në pyetje dhe intervistat janë marrë në përputhje të plotë me ligjin e Kosovës. Për të mbështetur pikëpamjen e tij se një Zyrtar Ligjor Ndërkombëtar mund të jetë aktiv në marrjen në pyetje në procedurë paraprake, Prokurori i

PSRK-së iu referua një aktgjykimi të mëparshëm të Gjykatës Komunale të Prishtinës në rastin PPS 10/11, duke cituar paragrafët e duhur të arsyetimit.

Ligji i zbatueshëm

46. Çështja e Zyrtarëve Ligjor të EULEX-it të cilët kryejnë intervista është diskutuar gjerësisht jo vetëm nga Kryetarja e Trupit Gjykses në vendimin e saj të datës 1 korrik 2013 në rastin MTPT 1, por gjithashtu nga Gjykata e Apelit në vendimin e saj në rastin MTPT 1, PN 577/2013. Kësisoj, Kryetarja e Trupit Gjykses do të përshkruajë shkurtimisht ligjin e zbatueshëm mbi këtë çështje dhe i lut palët që t'i referohen aktvendimeve të lartpërmendura.
47. Roli i Prokurorit të Shtetit drejtohet nga neni 109 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me Ligjin për Prokurorin e Shtetit (Ligji Nr. 03/L-225 i datës 30 shtator 2010), *Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës*, (Ligji Nr. 2008/03-L052), KPP dhe KPPK.
48. Veçanërisht, në pajtim me nenin 51 (1) të KPPK-së, prokurori publik vet ndërmerr të gjitha veprimet në procedurë penale për të cilat është i autorizuar sipas ligjit ose nëpërmjet personave të autorizuar sipas Ligjit mbi Prokurorinë Publike. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, prokurori publik vet ndërmerr veprime hetimore ose nëpërmjet policisë gjyqësore.
49. Brenda kuadrit ligjor ekzistues, roli i zyrtarit ligjor të EULEX-it nuk është definuar me ligj. Pozita e asistentit ligjor është paraparë në nenin 43 të Ligjit 32/1976 mbi Prokurorinë Publike, sipas të cilit “për kryerjen e detyrave në zyrat e Prokurorëve Publik, mund të përcaktohet numri i nevojshëm i asistentëve ligjor dhe stazhierëve. Si asistent ligjor në zyrën e Prokurorit Publik mund të caktohet një jurist i diplomuar, i cili ka të kryer provimin e jurisprudencës.” Megjithëse detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit ligjor nuk janë të detajuara në ligjin në fjalë, nuk mund të konsiderohet që asistenti ligjor të mund të veprojë si zëvendës apo përfaqësues i Prokurorit. E njëjta është e vërtetë në lidhje me ligjet dhe praktikat tjera të zbatueshme, sipas të cilave, pozitat e asistentëve ligjor shpallen nga Zyra e Krye Prokurorit të Shtetit.
50. Kompetenca për të marrë në pyetje të pandehurin përcaktohet në nenin 231 (1) të KPPK-së, i cili deklaron se:

“Të pandehurin e merr në pyetje prokurori publik. Prokurori publik marrjen në pyetje mund t’ia besojë policisë gjyqësore ose, në raste të jashtëzakonshme, policisë së rregullt.”

51. Lidhur me papranueshmërinë e deklaratave të të pandehurve, neni 156 i KPPK-së parashikon se deklarata e dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e neneve 229 deri në 236 të këtij Kodi. Këto deklarata mund të përdoren për të kundërshtuar dëshminë e të pandehurit në gjykatë (Neni 372 paragrafi 2 i këtij Kodi).

52. Disi në konflikt me këtë, formulimi i nenit 235 të KPPK-së parashikon si më poshtë:

“Nëse marrja në pyetje e të pandehurit është zbatuar me shkelje të dispozitave nga neni 155, paragrafi 1, neni 231, paragrafët 2 dhe 3 ose neni 234 paragrafi 2 i këtij Kodi, deklaratimet e të pandehurit janë të papranueshme.”

53. Kështu, ndërsa neni 156 (1) i KPPK-së përmban gjithashtu kërkesat e vendosura në nenin 231 (1) të KPPK-së, neni 235 nuk e bën këtë. Kryetarja e Trupit Gjyqësor gjen se e vetmja mënyrë e arsyeshme është të lexohet neni 235 i KPPK-së si një dispozitë që i shërben vetëm qëllimit të qartësimit të katër situatave të përmendura. Meqë të gjitha këto situata janë trajtuar edhe nga neni 156 (1) i KPPK-së, neni 235 nuk ka ndonjë kuptim të veçantë thelbësor.

54. Papranueshmëria e deklaratave të dëshmitarëve rregullohet nga neni 161 i KPPK-së, i cili nuk përmban paragraf gjegjësisht me nenin 156 (1) të KPPK-së. Megjithatë, do të zbatohen rregullat për kompetencën, të përcaktuara në ligjet që rregullojnë pozitën e prokurorëve. Siç u përmend më lart, vetëm prokurori i autorizuar me rregull ka kompetencë të ndërmarrë veprime hetimore. Për më tepër, në pajtim me nenin 249 (1.1) të KPP-së, Mbrojtja mund të ngrejë kundërshtimin se provat nuk u siguruan në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit, ose subjektet e tjera shtetërore.

55. Kodi nuk e specifikon kuptimin e nocionit “në mënyrë të ligjshme”, megjithatë është e qartë se ai do të interpretohet si “në pajtim me ligjin”, ose “bazuar në ligj”. Më e rëndësishme është se në Kod nuk ka dispozitë që të përcaktojë pasojat e një situate ku provat janë siguruar “në mënyrë të paligjshme”. Kodi qartazi shpall se provat janë të papranueshme vetëm në bazë të dispozitave të parashikuara në Kod. Sidoqoftë, Kryetarja e Trupit Gjyqësor

është e mendimit se mungesa e dispozitave të përpikta nuk e ndalon Gjykatën që provat e siguruara në mënyrë të paligjshme t'i trajtojë të papranueshme. Në radhë të parë, nga leximi i nenit 249 të KPP-së në tërësi, mund të supozohet ose nënkuptohet se provat që u gjet se ishin siguruar “në mënyrë të paligjshme” sipas nenit 249 (1.1), do të konsiderohen të papranueshme. Neni 249 (3) dhe (4) – që rrjedh nga neni 249 (1) – parashikon se Gjyqtari mund t'i “lejojë ose përjashtojë provat” dhe se “provat e papranueshme do të veçohen nga shkresat e lëndës dhe do të mbyllen” dhe “nuk do të shqyrtohen ose përdoren në procedurë penale.” Së dyti, trajtimi i provave, të siguruara në mënyrë të paligjshme, si të pranueshme nuk do të ishte i palogjikshëm, por, më e rëndësishmja, do të përbënte shkelje të parimeve kushtetuese të së drejtës për shqyrtim gjyqësor të drejtë, dhe do të binte ndesh me sundimin e ligjit.

iii. Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

56. Të gjitha dispozitat e cituara më lart vërtetojnë se pozita e prokurorit është individuale dhe ai lejohet t'ia delegojë kompetencat e tij prokurorëve të tjerë, policisë, ose policisë gjyqësore vetëm kur kjo gjë është parashikuar saktësisht me ligj. Ligji i zbatueshëm nuk parashikon mundësinë për t'ia besuar veprimet hetimore zyrtarëve ligjorë, roli dhe pozita profesionale e të cilëve nuk është rregulluar ligj, por përgjithësisht mund të përshkruhet për sa i përket mbështetjes për një gjyqtar a prokuror “të krahasueshëm me një vrojtues ose këshilltar”⁸. Asnjëra prej dispozitave të ligjeve të cekura nuk parashikon ndonjë kompetencë për zyrtarët ligjorë në procedura penale.

57. Kryetarja e Trupit Gjykses ndan të njëjtin mendim me Gjykatën Komunale në lëndën KA 44/12, se pjesëmarrja e zyrtarit ligjor në marrjen në pyetje të të pandehurve dhe dëshmitarëve në parim nuk përbën shkelje të nenit 231 të KPPK-së, por vetëm në rast se kjo është kryer nga Prokurori i cili është qartazi përgjegjës për mënyrën dhe drejtimin e intervistimit.

58. Nisur nga objektivi dhe qëllimi i nenit 231 (1) të KPPK-së, që është të shmanget marrja në pyetje e të pandehurit nga persona të pa autorizuar, është e qartë se termi “kryerja” duhet kuptuar se Prokurori duhet të ketë kontroll në drejtimin e marrjes në pyetje. Kështu që pjesëmarrja aktive e një zyrtari ligjor ose këshilltari ligjor në marrjen në pyetje të një të

⁸ Gjykata Supreme, Ap.-Kz. Nr. 527/2012 (“Kleçka”), Aktvendim, 11 dhjetor 2012, paragrafi 28

pandehuri nuk përbën shqetësim për sa kohë që marrja në pyetje qartazi udhëhiqet nga prokurori kompetent. Kjo jo vetëm që kërkon praninë e përhershme të Prokurorit gjatë marrjes në pyetje, por edhe ushtrimin e autoritetit të përgjithshëm të tij në shtruarjen e pyetjeve dhe drejtimin e aspekteve themelore të marrjes në pyetje.

59. Kryetarja e Trupit Gjykes në rastin MTPT 1, në vendimin e saj të datës 1 korrik 2013, gjeti se “praktika se një zyrtar ligjor, roli i cilit është i rëndësishëm por vetëm mbështetës, bënë marrjen në pyetje të dëshmitarëve pa *de facto* kontrollin e prokurorit është e papranueshme dhe e paligjshme pasi që është në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm”.⁹ Në të njëjtën mënyrë, Gjykata e Apelit konsidëron se “për të përcaktuar nëse deklaratat e dëshmitarëve janë të pranueshme apo jo, trupi gjykes duhet të përcaktojë nëse mund të thuhet se Zyrtari Ligjor ka *kryer intervistimin* (...) personi kryen intervistimin kur ai/ajo duket të jetë autoriteti që udhëheq intervistimin duke kontrolluar marrjen në pyetje dhe drejtimin e intervistës”.¹⁰ [theksim i origjinalit] Gjykata e Apelit shkoi më tej dhe dha shembuj të rolit udhëheqës, të tillë si, nëse Zyrtari Ligjor ka shtruar shumicën e pyetjeve, nëse ai i ka përcjellë përgjigjet dhe ka shtruar pyetje relative, nëse ai ka reaguar ndaj përgjigjeve, nëse ai kryesisht ka shtruar pyetje të përgatitura paraprakisht apo nëse ai ka përshtatur drejtimin e marrjes në pyetje.
60. Bazuar në këtë tanimë jurisprudencë ekzistuese, Kryetarja e Trupit Gjykes ka analizuar tërësisht procesverbalet e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të të pandehurve në këtë rast, në lidhje me të cilat janë ngritur kundërshtimet nga Mbrojtja.

(i) Dëshmia në procedurë paraprake e të pandehurit S.T.

61. Të dytë, Prokurori i PSRK-së Johannes Pickert dhe Zyrtari Ligjor Bernhard Kuschnik ishin të pranishëm në intervistim dhe të dytë i shtruan pyetje të pandehurit. Sipas procesverbalit të dëshmisë në procedurë paraprake, Prokurori i PSRK-së filloi intervistën, i sqaroi arsyet për intervistë, dhe e informoi të pandehurin se ishte i dyshuar në rastin në fjalë dhe për të drejtat e tij. Pas disa pyetjeve fillestare, Prokurori i PSRK-së deklaroi se Zyrtari Ligjor do t'i shtronte pyetjet e përgatitura. Zyrtari Ligjor vazhdoi me shtruarjen e pyetjeve të pandehurit.

⁹ Gjykata Themelore e Prishtinës, Aktvendim mbi kundërshtimet ndaj provave dhe kërkesave për hüdhen e aktakuzës, PKR 84/18 (MTPT 1), 1 korrik 2013, para. 83.

¹⁰ Gjykata e Apelit, PN 577/2013 (MTPT 1), Aktvendim mbi ankesat, 10 dhjetor 2013, paras. 52-53.

Gjatë tërë intervistës, Zyrtari Ligjor shtroi shumicën e pyetjeve, që dukej se ishin përgatitur paraprakisht, por gjithashtu dhe disa pyetje përcjellëse, ndërsa Prokurori i PSRK-së shtroi disa pyetje tjera përcjellëse. Në mes të intervistës, Zyrtari Ligjor i dha gjithashtu udhëzime Avokatit Mbrojtës se si ta informojë klientin e tij nëse ai donte të konsultohet me të para përgjigjes së pyetjes, kështu që do të shënohet zyrtarisht në procesverbal. Përfundimisht, ishte Prokurori i PSRK-së, që e përfundoi intervistimin duke informuar se nga ana e tyre nuk kishte më pyetje dhe duke i lejuar të pandehurit të lexonte procesverbalin e intervistës.

62. Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të intervistës dhe karakteristikat e mënyrës në të cilën është kryer intervista, në bazë të asaj që u tha më lart, Zyrtari Ligjor nuk ka patur kontroll të përgjithshëm të intervistës. Edhe pse Zyrtari Ligjor ka kryer intervistën në një masë, Prokurori i PSRK-së kishte kontrollin dhe udhëheqjen e përgjithshme të intervistës. Përveç kësaj, duke patur parasysh faktin se shumica e pyetjeve të shtruar ishin përgatitur para intervistës, roli aktiv që ka luajtur Zyrtari Ligjor gjatë intervistës nuk duket të jetë vendimtar. Si pasojë, përfshirja e Zyrtarit Ligjor në këtë instancë të veçantë ishte i ligjshëm, dhe procesverbali i dëshmisë në procedurë paraprake i të pandehurit S.T. duhet të pranohet në prova.

(ii) Dëshmia në procedurë paraprake e të pandehurit A.A.

63. Prokurorët e PSRK-së Johannes Pickert dhe Robert Kucharski, si dhe Zyrtari Ligjor Bernhard Kuschnik ishin të pranishëm në intervistë. Sipas procesverbalit të dëshmisë në procedurë paraprake, intervistën e filloi Prokurori i EULEX-it, e pyeti të pandehurin nëse kishte Avokat Mbrojtës, i sqaroi arsyet për intervistë, dhe e informoi të pandehurin se ai ishte i dyshuar në këtë rast dhe për të drejtat e tij. Pas disa pyetjeve fillestare të shtruar nga Prokurori i PSRK-së, Zyrtari Ligjor filloi t'i shtronte pyetje të pandehurit. Pyetja e parë e shtruar nga Zyrtari Ligjor nuk ishte një pyetje e përgatitur, por një pyetje përcjellëse në lidhje me të afërmit e të pandehurit. Shumica e pyetjeve në intervistë u shtruan nga Zyrtari Ligjor, në veçanti në lidhje me takimet me të pandehurit F.L. dhe S.T. gjatë kohës së Aktakuzës (2008). Zyrtari Ligjor ishte ai që e ballafaqoi të Pandehurin me prova të dokumentuara (përgjiemt e telefonit nga viti 2008) dhe përmbajtjet e tyre, siç është paraqitur nga Prokurori i PSRK-së.
64. Prokurorët e PSRK-së ndërhyjnë herë pas here dhe ishin ata që pyetën drejtpërdrejtë nëse i pandehuri A.A. kishte bërë ndonjëherë marrëveshje për Kompaninë B. Company, si dhe disa

pyetje që dalin nga pyetjet e telefonave. Pjesa tjetër e intervistës, megjithatë ishte kryer nga Zyrtari Ligjor. Ai jo vetëm që shtroi pjesën më të madhe të pyetjeve, por pyetjet e tilla ishin të lidhura, të përgatitura dhe përcjellëse, në vend se të ishin vetëm të përgatitura paraprakisht. Intervista u përfundua nga Prokurori i EULEX-it, i cili e informoi të pandehurin se ai kishte të drejtë të lexonte procesverbalin e intervistës apo që t'i lexohet ai.

65. Duke patur parasysh atë që u tha më lart, dhe rolin e ushtruar nga Zyrtari Ligjor gjatë tërë intervistës, dëshmia në procedurë paraprake e të pandehurit A.A. nuk duhet të pranohet në prova. Zyrtari Ligjor kishte një rol udhëheqës gjatë tërë intervistës dhe mund të konsiderohet si ai që e udhëhoqi atë. Siç u sqarua më lart, përfshirja e Zyrtarit Ligjor në një mënyrë të tillë është e paligjshme dhe prandaj, procesverbali i dëshmisë në procedurë paraprake i A.A. duhet të deklarohet i papranueshëm, në pajtim me nenin 249(1.1) të KPP-së.

(iii) Dëshmia në procedurë paraprake e të pandehurit B.D.

66. Në intervistën e të pandehurit B.D., ishin të pranishëm Prokurori i EULEX-it Johannes Pickert dhe Zyrtarët Ligjor Bernhard Kuschnik dhe Manuel Eising. Sipas procesverbalit të dëshmisë në procedurë paraprake, Prokurori i EULEX-it filloi intervistën, i sqaroi arsyet e mbajtjen e saj, dhe e informoi të pandehurin se ai ishte i dyshuar në rastin në fjalë dhe për të drejtat e tij. Prokurori i EULEX-it vazhdoi me marrjen në pyetje. Zyrtari Ligjor Bernhard Kuschnik pastaj ndërhyri për ta ballafaquar të pandehurin me prova rreth përfshirjes së kompanisë së të pandehurit dhe shtroi disa pyetjeve përcjellëse bazuar në përgjigjen e marrë. Shumica e pyetjeve në lidhje me procesin e tenderit u shtruan nga Prokurori i EULEX-it; megjithatë, Zyrtari Ligjor shtroi shumicën e pyetjeve të përgatitura dhe përcjellëse në lidhje me çmimin e ofertës së të pandehurit dhe llogaritjen e saj. Në fakt, subjekti i çmimit të ofertës dhe zbritjes së dhënë nga kompania B. në procesin e tenderit, një çështje që është vendimtare në rastin e Prokurorisë, ka rrjedhë nga njëra prej pyetjeve përcjellëse të Zyrtarit Ligjor, duke treguar rolin udhëheqës të Zyrtarit Ligjor të ushtruar gjatë intervistës. Zyrtari Ligjor vazhdoi të shtrojë shumicën e pyetjeve në lidhje me çmimin dhe ishte ai i cili e ballafaqoi të pandehurin me prova të dokumentuara. Zyrtari Ligjor ishte ai i cili gjithashtu deklaroi se nuk kishte më pyetje për të pandehurin. Intervista është përfunduar nga Prokurori i EULEX-it

duke e falënderuar të pandehurin për pjesëmarrjen në intervistë dhe duke e këshilluar se ai kishte të drejtë të lexonte procesverbalin apo që ai t'i lexohej atij.

67. Duke patur parasysh rëndësinë e pyetjeve të shtruara nga Zyrtari Ligjor Bernhard Kuschnik (psh., llogaritja e çmimit dhe zbritja) dhe mënyrën se si u shtjellua intervista, ngjet se Zyrtari Ligjor ishte në fakt duke luajtur rolin kryesor në intervistën e të pandehurit B.D.. Zyrtari Ligjor Bernhard Kuschnik ndryshoi drejtimin e marrjes në pyetje kur ai vazhdoi me llogaritjen e çmimit, duke reflektuar sjelljen e tij gjat tërë intervistës. Si rezultat, procesverbali i dëshmisë në procedurë paraprake i B.D. është i papranueshëm, në pajtim me nenin 249 (1.1) të KPP-së.

(iv) Intervista në procedurë paraprake e dëshmitarit Hamid Dema

68. Prokurori i EULEX-it Johannes Pickert dhe Zyrtari Ligjor Bernhard Kuschnik ishin të pranishëm në intervistë. Prokurori i EULEX-it e paralajmëroi dëshmitarin për obligimet të thoshte të vërtetën dhe e informoi atë për të drejtat e tij, duke vazhduar menjëherë me marrjen në pyetje të dëshmitarit nga Zyrtari Ligjor. Prokurori i EULEX-it, nësrhyri herë pas here duke shtruar pyetje përcjellëse dhe duke i kërkuar dëshmitarit të jepte detaje të mëtejme në çështje të caktuara. Si në intervistën e B.D., Zyrtari Ligjor shtroi pyetje në lidhje me çmimin e ofertës së B. dhe llogaritjen e tij. Më pastaj, Zyrtari Ligjor e ndryshoi drejtimin e intervistës duke paraqitur një çështje të re për tu shfrytëzuar. Më pastaj, të gjitha pyetjet janë hstruar nga Zyrtari Ligjor pa asnjë ndërhyrje nga Prokurori i EULEX-it, i cili pastaj ndërhyri vetëm për të thënë se nuk kishte më pyetje.

69. Bazuar në atë që u tha më lart, Kryetarja e Trupit Gjykses vie në përfundim se Zyrtari Ligjor ishte në fakt duke udhëhequr intervistën e H.D. dhe, prandaj, procesverbali i intervistës së H.D. në procedurë paraprake duhet të konsiderohet i papranueshëm, sipas nenit 249 (1.1) të KPP-së.

(v) Intervista në procedurë paraprake e dëshmitarit Ismet Mazreku

70. Dëgjimi i I.M. është mbajtur më 12 janar 2012 para Zyrtarit Hetues të PK-së, Z.I. i cili i shtroi të gjitha pyetjet dëshmitarit. Zyrtari Ligjor nuk ishte i pranishëm në gjatë dëgjimit të tij. Si rezultat, parashtesa e mbrojtjes se kjo dëshmi është e papranueshme sepse veprimi

hetimor është kryer nga zyrtari ligjor, refuzohet si e pabazë, përkundër vlerësimit të mësipërm të relevancës së kësaj çështje në rastin në fjalë.

71. Duke patur parasysh ligjin dhe faktet e paraqitura më lart, Kryetarja e Trupit Gjykes vie në përfundim se provat në vijim janë të papranueshme, pasi që ato janë marrë në mënyrë të paligjshme (neni 249 (1.1) i KPP-së) sepse ato janë udhëhequr nga një person që nuk autorizohet nga ligji që të kryejë veprimet hetimore:

- deklarata e dëshmitarit I.M. e datës 12 janar 2012 ;
- deklarata e dëshmitarit XH.R. e datës 6 dhjetor 2010 ;
- deklarata e dëshmitarit H.D. e datës 18 mars 2013
- deklarata e të pandehurit A.A., e datës 15 mars 2013 ;
- deklarata e të pandehurit B.D., e datës 14 mars 2013 ;

6. Pranueshmëria e dokumenteve të marra nga kontrolli dhe konfiskimi i kryer në shtëpinë e F.L.t në Çagllavicë dhe në Kuvend, më datën 28 prill 2010.

Prashtresat e palëve

72. Mbrojtja e F.L. paraqet se kontrolli i shtëpisë së F.L. në Çagllavicë më datën 28 prill 2010 është kryer në shkelje të nenit 245 (6) në lidhje me nenin 245 (3) të KPP-së dhe nenit 36.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe prandaj, provat e marra nga kontrolli janë të papranueshme.

73. Mbrojtja pohon se kontrolli nuk mund të bazohet kryesisht në një urdhër gojor të gjykatës pa miratim gjyqësor me shkrim të bërë më pastaj. Është paraqitur se neni 246 (1) i KPPK-së parasheh qartë se një kontroll i kryer pa një urdhër nga gjyqtari i procedurës paraprake është në shkelje të Kodit dhe nenit 245 (6) të KPPK-së, pasi që kërkohet që një kontroll i kryer pa një urdhër me shkrim duhet të raportohet tek gjyqtari i procedurës paraprake brenda 12 orëve.

74. Prokuroria paraqet se kundërshtimi i ngritur nga mbrojtja është i pameritë. Sipas mendimit të Prokurorisë është KPPK dhe jo KPP, që zbatohet për të përcaktuar nëse ka ndodhur një shkelje e ligjit gjatë mbledhjes së provave, duke u bazuar se vlerësimi duhet të aprovohet në

bazë të ligjit, pasi që ai ka ekzistuar kur është kryer veprimi hetimor. Është argumentuar nga Prokuroria se kontrolli i shtëpisë së F.L. është kryer në pajtim me nenin 245 (3) të KPPK-së, bazuar në urdhërin gojor për kontroll, lëshuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake i EULEX-it, Ferdinando Buatier de Mongeot.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykues

75. Në aktvendimin e datës 01 korrik 2013 në rastin MTPT 1, Kryetarja e Trupit Gjykues gjeti se provat e marra nga kontrolli i shtëpisë së F.L. në Çagllavicë më datën 28 prill 2010 ishin të papranueshme sepse ai ishte kryer në shkelje të dispozitave të nenit 246 (4) të KPPK-së, pasi që parakushtet për të kryer këtë veprim hetimor pa një urdhër gjykate nuk janë përmbushur. Mbrojtja në rastin MTPT 1 ka ngritur të njëjtat kundërshtime kundër provave të marra nga kontrolli ashtu si në procedurën aktuale penale.
76. Gjykata e Apelit, me Aktvendimin e datës 10 dhjetor 2013, nuk ka ndarë mendimin e Kryetares së Trupit Gjykues dhe konsideroi se kontrolli i kryer në shtëpinë e F.L. në Çagllavicë ishte i ligjshëm dhe provat e marra të pranueshme¹¹. Dëshmitë e dokumentuara të kundërshtuara nga mbrojtja janë pjesë e gjërave të gjetura kontrollit. Nuk ka rrethana të reja që do të justifikonin një vlerësim tjetër ligjor mbi pranueshmërinë përveç atij të Gjykatës së Apelit.
77. Duke patur parasysh se mbrojtja nuk kanë ngritur ndonjë argument të ri kundër provave të marra nga kontrolli i kryer në shtëpinë e F.L. në Çagllavicë, Kryetarja e Trupit Gjykues gjen se kundërshtimi është i pabazuar.

7. Kundërshtimi ndaj propozimit të Prokurorisë për të dëgjuar disa zyrtarë policie si dëshmitarë gjatë shqyrtimit gjyqësor (mbrojtja e F.L.t)

Prashtresa e palëve

78. Mbrojtja vë në pyetje të drejtën e Prokurorisë për të propozuar që të dëgjoen si dëshmitarë disa zyrtarë policie. Është paraqitur se këta zyrtarë janë udhëhequr dhe mbikëqyrur nga prokuroria dhe, prandaj, ata duhet të diskualifikohen nga të dëshmuarit në gjykatë.

¹¹ Court of Appeals, PN 577/2013 (MTPT 1), Ruling on Appeals, 10 December 2013, para. 86 - 99

79. Prokurori i PSRK-së në përgjigjen e tij me shkrim paraqet se kundërshtimi duhet të refuzohet si i pabazë sepse nuk ka kurrfarë dispozite ligjore, që do të parandalonte marrjen në pyetje si dëshmitarë të zyrtarëve të policisë. Për të mëbshtetur qëndrimin e tij, i është bërë referencë nenit 124 (1), që lejon thirrjen e një pëersoni si dëshmitar nëse ka të ngjarë që ai ose ajo mund të japë informata për veprën penale, dhe nenet 126 dhe 127 të KPP-së, që specifikojnë katalogun e dëshmitarëve të privilegjuar dhe të dëshmitarëve që përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykes

80. Kundërshtimi i ngritur nga mbrojtja është i papranueshëm sepse kjo çështje nuk është brenda bazave të mundshme të cekura në nenin 249 (1) të KPP-së. Mbrojtja mund të paraqesë një kërkesë për kundërshtimin e propozimit të Prokurorisë për dëshmitarët, në çdo kohë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kryetarja e Trupit Gjykes do të sigurojë që provat të jenë marrë në pajtim me Kapitullin XVI të KPP-së, gjatë vendosjes mbi një kërkesë të tillë, në pajtim me nenin 299 (5) të KPP-së.

8. Pranueshëmria e provave të mbledhura pas datës 23 prill 2012 (mbrojtja e N.K.t)

Parashtresa e palëve

81. Mbrojtja e N.K.t paraqet se provat e marrë pas 23 prillit 2012 janë të papranueshme për shkak të afateve kohore për të përfunduar hetimin në këtë rast, në pajtim me nenin 225(2) të KPPK-së dhe nenit 159 të KPP-së.

82. Prokurori Special në përgjigjen e tij argumenton se afatet kohore të përshkruara me ligj janë respektuar në mënyrë rigorozë. Ai paraqet se hetimi në rastin në fjalë është filluar më datën 8 gusht 2012 kundër të pandehurit N.K. kështu që periudha kohore e hetimit do të skadojë më 8 gusht 2014, nëse nuk do të ishte ngritur asnjë aktakuzë. Tutje, kjo çështje tanimë është adresuar nga Gjykata Themelore në lidhje me Aktakuzën PPS 425/09 (MTPT 1) ku argument e mbrojtjes u refuzuan në mënyrë të drejtë.

Ligji i zbatueshëm

83. Në pajtim me dispozitën kalimtare paraparë në nenin 540 të KPP-së, dispozitat e këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht për çdo procedurë penale të filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodit në të cilën nuk është ngritur aktakuzë. Gjykata Supreme ka sqaruar se KPP zbatohet për të gjitha procedurat penale në vazhdim të filluara para hyrjes në fuqi të tij, përveç për rastet kur shqyrtimi gjyqësor veçmë ka filluar apo kur një rast është dërguar për rigjykim.¹²
84. Në pajtim me nenin 159 (1) të KPP-së hetimi duhet të përfundojë brenda dy viteve dhe gjatë kësaj kohe duhet të ngritet aktakuza. Sipas paragrafit 2, gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim prej gjashtë muaj të hetimit, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjyqësor

85. Hetimi që ka të bëjë me të pandehurit në këtë rast është filluar më 8 gusht 2012, d.m.th. para hyrjes në fuqi të KPP-së. Megjithëse më vonë hetimi PPS 79/12 është bashkuar me PPS 67/10, mbetet fakti se hetimi kundër N.K. dhe të pandehurve tjerë në këtë rast ka filluar më atë datë. Më 28 janar 2013, Gjykata e Apelit, në përcaktimin e rastit PPS 67/10, duke vendosur në një ankesë të paraqitur nga Prokuroria kundër vendimit të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake të Gjykatës Themelore të Prizrenit për refuzimin e kërkesës së Prokurorisë për vazhdimin e hetimit, theksoi se: “çdo hetim që ka filluar para hyrjes në fuqi të KPP-së dhe në atë kohë ishte në vazhdim apo vendimi për vazhdimin është paraqitur me kohë dhe është i papërfudnuar është *ex lege* i autorizuar të zgjasë deri në 2 vjet”.¹³
86. Duke patur parasysh këtë jurisprudencë dhe sipas ligjit të zbatueshëm, periudha hetimore në rastin aktual është zgjeruar *ex lege* me hyrjen në fuqi të KPP-së së ri, sa i përket të pandehurve dhe veprave penale që i nënshtrohen Aktakuzës aktuale. Pasi që afatet kohore për vazhdim dhe zgjerim të periudhave hetimore duhet të llogariten në mënyrë të pavarur dhe ndaras për secilin të pandehur dhe vepër penale, hetimi i filluar më 8 gusht 2012 kundër F.L., S.T., N.K., A.A. dhe B.D. për veprat penale Krimi i organizuar, Lidhja e kontratës së dëmshme, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, Keqpërdorimi i autorizimeve në

¹² Gjykata Supreme, Mendim Ligjor 56/2013, 23 janar 2013.

¹³ Dosja 1, fq. 4; Gjykata e Apelit, PN/KR 93/2013, Aktvendim mbi ankesën, 28 janar 2013, para. 13.

ekonomi, Marrja dhe Dhënia e ryshfetit, do të skadojë më 8 gust 2014, nëse PSRK nuk do të kishte ngritur Aktakuzën PPS 67/10. Hetimi i filluar më 1 nëntor 2012 kundër F.L. dhe N.K. përmes Aktvendimit mbi zgjerimin e hetimeve do të skadojë më 1 nëntor 2014, nëse PSRK nuk do të kishte ngritur Aktakuzën PPS 67/10.

87. Pra, parashtresa e mbrojtjes është e pameritë për shkak se më 18 shkurt 2014, koha kur Aktakuza është ngritur, periudhat e hetimit ishin duke vazhduar akoma.

9. Provat e paraqitura nga Prokurori nuk janë të besueshme (mbrojtja e N.K.)

Parashtresa e palëve

88. I pandehuri N.K. në parashtresën e tij argumenton se nuk ka asnjë provë të besueshme për të mbështetur aktakuzën.

89. Prokurori nuk është përgjigjur ndaj këtij kundërshtimi.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

90. Kryetarja e Trupit Gjykses gjen se kundërshtimi i N.K. duhet të hudhet si i pabazë. I pandehuri nuk paraqiti ndonjë argument në mbështetje të parashtresës së tij, e as nuk iu referua ndonjë gjëje specifike të provave që do të duhej të deklarohesh thelbësisht e pambështetshme sipas nenit 19 (1.29) dhe 259 të KPP-së.

91. Besueshmëria e provave të paraqitura nga Prokurori mund të vlerësohen si duhet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor kur palët do të paraqesin prova për të mbështetur qëndrimin e tyre. Atyre gjithashtu do u jepet mundësia të kundërshtojnë provat e paraqitura nga secila palë.

10. Përmbledhje

92. Provat në vijim janë të papranueshme dhe duhet të përjashtohen na shkresat dhe të mbyllen:

- deklarata e dëshmitarit I.M. e datës 12 janar 2012¹⁴;
- deklarata e dëshmitarit XH.R. e datës 6 dhjetor 2010¹⁵;
- deklarata e dëshmitarit H.D. e datës 18 mars 2013¹⁶
- deklarata e të pandehurit A.A., e datës 15 mars 2013¹⁷;
- deklarata e të pandehurit B.D., e datës 14 mars 2013¹⁸;
- raporti i ekspertit nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë¹⁹;
- padia e paraqitur nga paditësi A.H.M. në Gjykatën Komunale të Malishevës për vërtetimin e të drejtës së pronësisë të një prone të paluajtshme, e datës 4 korrik 2007²⁰;
- të gjitha provat që janë mbledhur pas datës 6 prill 2008 në ekzekutimin e “Urdhërit për aplikimin e masave të fshehta”²¹, lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës (PPN 697-7/07) më 6 shkurt 2008.

IV. Kërkesat për hudhjen e Aktakuzës

1. *Standardi i zbatueshëm i shqyrtimit*

93. Kërkesa për hudhjen e aktakuzës parashihet me nenin 250 të KPP-së, që i lejon të pandehurit ta kërkojë atë, nëse nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se ai ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.
94. Sa i përket kërkesave për të hudhur Aktakuzën, KPP parasheh kritere të qarta që duhet të merren parasysh. Si rezultat nga neni 250 (1) dhe neni 253 (1) i KPP-së, para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesën për hudhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:
- vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;

¹⁴ Dosja 6, pp. 58 et seq.

¹⁵ Dosja 6, pp. 100 et seq.

¹⁶ Dosja 6, pp. 1 et seq.

¹⁷ Dosja 5, pp. 131 et seq.

¹⁸ Dosja 5, pp. 375 et seq.

¹⁹ Dosja 1, pp. 126 et seq.

²⁰ Dosja 1, pp. 112 et seq.

²¹ Dosja 4, pp. 85 et seq.

- ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- ka kaluar afati i parashrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje, ose ekzistojnë rrethana tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose
- nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.”

95. Dyshimi i bazuar mirë është definuar në nenin 19 (1.12) të KPP-së dhe nënkupton “posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri”. Standardi i “vëzhguesit objektiv” kërkon prova që do të bindnin shumicën e njerëzve se krimi është kryer nga i pandehuri.

96. Neni 241 i KPP-së kërkon që Aktakuza duhet të përcaktojë veprën penale të pretenduar me saktësi duke cekur kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale dhe rrethanat tjera të nevojshme. Sipas nenit 1 (3) të KPP-së, definicionet e e krimit duhet të interpretohen në mënyrë të saktë, nuk lejohet interpretimi përmes analogjisë, dhe nëse ka ndonjë paqartësi, definicioni i krimit duhet të interpretohet në favor të personit që është duke u ndjekur penalisht.

2. Parashtrësit e palëve - vërejtje të përgjithshme

97. Mbrojtësit e të gjithë të pandehurve kanë parashtruar kërkesa për të hudhur aktakuzën në arsyet e përshkruara në nenin 250 (1.4) të KPP-së, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen në aktakuzë.

98. Prokurori në përgjigjen e tij nuk u pajtua me mbrojtjen, dhe ai mbështeti se çdo akuzë kundër të pandehurve është e mbështetur me dëshmi të mjaftueshme të dyshimeve të bazuara mirë se ata kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkohen.

3. Aktakuza është e mangët formalisht

Parashtrësit e palëve

99. Mbrojtja e F.L. paraqet se Aktakuza është e mangët formalisht për shkak se nuk përputhet me kërkesat e specifikuara në nenin 241 (1.4) të KPP-së lexuar së bashku me nenin 2 (3) të KPP-së. Është argumentuar se “Prokurori nuk ka përcaktuar saktësisht definicionin e veprave penale” që sipas mendimit të mbrojtjes, përbën shkelje jo vetëm të nenit 241 (1.4) të KPP-së, por gjithashtu të parimit të ligjshmërisë (neni 3 (2) i KPP-së). Në veçanti, vendndodhja e saktë, koha dhe qëllimi i dhënies së tenderëve kompanive të veçanta nuk janë përcaktuar në Aktakuzë.²² Tutje, mbrojtja paraqet se në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 241 (1.7) të KPP-së, Aktakuzës i mungojnë referenca të qarta për dëshmi në lidhje me faktet.
100. PSRK nuk ka paraqitur një kërkesë në lidhje me këtë çështje.

Ligji i zbatueshëm

101. Neni 241 i KPP-së parasheh se sa i përket veprës penale, me të cilën ngarkohet i pandehuri, aktakuza duhet të përmbajë:

- kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale;
- rekomandimin për provat që duhet prezentuar në shqyrtimin gjyqësor së bashku me emrat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shkresat që duhet lexuar dhe sendet që duhet marrë si provë.

102. Neni 242 i KPP-së përcakton veprimet që do të ndërmerren nga gjykata pas ngritjes së Aktakuzës, dhe këto janë si në vijim:

- caktimi i gjyqtarit ose trupit gjykues me kryetarin e tij nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, ashtu siç duhet (paragrafi 2).
- përcaktimi sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përbën aktakuzën (paragrafi 3).
- caktimi i menjëhershëm i shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës (paragrafi 4), por nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e

²² Shih parashtrësën e mbrojtjes parag. 18 dhe 27.

parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës (paragrafi 5).

103. Neni 442 i KPP-së rregullon metodën e paraqitjes së parashtresave. Siç rezulton nga paragrafi 3, një parashtresë duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmbajë çdo gjë të nevojshme që të mund të veprohet sipas saj. Paragrafi 4 parasheh që kur parashtresa e paraqitur nuk përmbush këto kërkesa, thirret paraqitësi i parashtresës për të korrigjuar apo plotësuar parashtresën, përveç nëse me këtë Kod nuk është paraparë ndryshe.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

104. Kryetarja e Trupit Gjykses gjen se sipas Kodit të ri të Procedurës Penale, vlerësimi nëse aktakuza përmbush kërkesat e parapara me ligj mund të bëhet vetëm në fazën e shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë. Kodi përcakton saktësisht të gjithë hapat që duhet të ndërmerren dhe vendimet që duhet të lëshohen. Kryetarja e Trupit Gjykses pohon se, në kundërshtim me KPPK-më, KPP-ja lejon lejon t'i drejtohem çështjes së kuptueshmërisë së aktakuzës vetëm gjatë shqyrtimit fillestar. Ky ishte gjithashtu dhe synimi i ligjvënësit, pasi që Kodi i ri nuk përmban një dispozitë të ngjashme si ajo që gjendej në nenin 306 (2) të KPPK-së, që parashihte " *Menjëherë pas pranimit të aktakuzës gjyqtari, i cili zbaton procedurën për konfirmim të aktakuzës verifikon se a është përpiluar aktakuza në pajtim me nenin 305 të këtij Kodi.*"

105. Kryetarja e Trupit Gjykses vëren se është çështje e drejtësisë që mbrojtja dhe gjykata të jenë në dispozicion të një aktakuze të plotë duke theksuar akuzat me saktësinë e nevojshme. Është e drejtë themelore e përfshirë në nenin 30 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 6 (3) a) të KEDNj që " *çdokush që akuzohet për veprë penale ka të drejtë të informohet me përpikëri, në gjuhën në të cilën ai/ajo e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij*". Vetëm një dokument i detajuar dhe i plotë që përmban akuzat do t'i mundësonte të pandehurit të përgatitej për një mbrojtje efikase.²³ Për këto arsye kërkesa e mbrojtjes do të konsiderohet e pranueshme.

²³Shih Gjykata Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, *Pélissier and Sassi v. France* [GC], para. 54; *Dallos v. Hungary*, para. 47; Shih tutje ICTY, *Prokurori v. Zoran Kupreski, Mirjan Kipreski, Vlatko Kupreski, Drago Kupreski dhe Vladimir Šantic*, Rasti Nr. IT-95-16-A, Aktgjykimi i datës 23 tetor 2001, para. 88: "Nëse një aktakuzë pranohet me hollësi të mjaftueshme varet nëse ajo përcakton faktet materiale të rastit të Prokurisë me detaje të mjaftueshme për të

106. Kërkesa e një njoftimi me shkrim për bazën faktike dhe ligjore të akuzave mbron të drejtën themelore të të pandehurit për tu informuar plotësisht për to dhe çështjen dhe qëllimin mbi të cilat duhet të vendosë gjykata. Detyrimi për të informuar të pandehurin për akuzat i mbetet Prokurorisë. Kjo përfshin nevojën për të informuar në lidhje me shkakun e akuzës, d.m.th. veprimet të cilat i pandehuri pretendohet të ketë kryer dhe në të cilat bazohet akuzat, si dhe natyra e akuzës, d.m.th. karakterizimi ligjor që i është dhënë këtyre veprimeve.²⁴
107. Në aspektin e përshkrimit të kërkuar të veprës penale, siç parashihet me nenin 241 (1.4) të KPP-së, Gjykata e Apelit sqaroi se Aktakuza “duhet të përfshijë të gjitha elementet që vendosin veprën penale në fjalë dhe informacion të mjaftueshëm për ta ndarë atë nga veprat tjera”. Tutje, Gjykata vërejti se për të vlerësuar nëse aktakuza është e kuptueshme “[ajo] duhet të shqyrtohet si tërësi, që do të thotë se edhe pjesa e akuzës e edhe pjesa e arsyetimit duhet të lexohen së bashku”.²⁵
108. Në bazë të këtyre interpretimeve, parashtresa e mbrojtjes se Aktakuza PPS 67/10 nuk ofron përshkrim të mjaftueshëm të veprave penale, është e pabazë. Mbrojtja në veçanti fillon diskutimin me faktin se sa i përket pikës 1 të pjesës së akuzës në Aktakuzë vetëm përmendet “në Kosovë në vitin 2008” që sipas mendimit të mbrojtjes, nuk është përshkrim i mjaftueshëm i kohës dhe vendit të kryerjes së veprës penale. Megjithatë është e saktë se pjesa e parë e aktakuzës (“përshkrimi dhe emrat ligjor të veprave penale”) nuk ofron ndonjë informacion të detajuar në pikën 1, por sqarimet e dhëna në pikat tjera, posaçërisht në pikat 3 dhe 6, janë të detajuara. Nuk është gjithashtu e nevojshme që vendi dhe data e saktë të përmenden në Aktakuzë për sa kohë veprimi është në mënyrë të qartë i identifikueshëm dhe i dallueshëm, d.m.th. nuk ekziston rreziku që veprimi i akuzuar të mund të ngatërrohet me veprime tjera. Nga leximi i Aktakuzës si tërësi, duhet të shihet si e tillë që ofron informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar që i lejon të pandehurve, që të përgatisin mbrojtjen e tyre në mënyrë adekuate dhe efektive.
109. Për më tepër, parashtresa e mbrojtjes se Aktakuza nuk përmban kërkesat e përcaktuara në nenin 241 (1.7) të KPP-së, është e pabazë. KPP e bënë të qartë në mënyrë të

informuar një të akuzuar në mënyrë të qartë për akuzat kundër tij kështu që I akuzuari të mund të përgatisë mbrojtjen e tij”.

²⁴ Shih Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut, *Mattocchia v. Italy*, para. 59; *Penev v. Bulgaria*, paras. 33 dhe 42; Shih tutje ICTY, *Prokurori v. Milorad Krnojelac*, Rasti Nr. IT-97-25-A, 17 shtator 2003, paras. 131 et seq.

²⁵ Gjykata e Apelit, Aktvendimi mbi ankesën, PN 577/13 (“MTPT 1”), 10 dhjetor 2013, para. 218.

detyrueshme për prokurorinë që të sigurohet se aktakuza përmban sqarimin e provave në lidhje me faktet kyçe të rastet të prokurorisë. Kjo kërkesë tanimë është diskutuar gjerësisht nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Gjykata e Apelit sa i përket Aktakuzës PPS 425/09 (MTPT 1). Megjithatë, rasti aktual ndryshon nga ai i mëparshmi në atë se Aktakuza PPS 67/10 ofron një numër të pranueshëm dhe të mjaftueshëm të referimeve për të provuar bazën e akuzave.

110. Duke patur parasysh atë që u tha më lart, Kryetarja e Trupit Gjykues gjen se kërkesa për të hudhur aktakuzën për arsye se ajo nuk përmbush kërkesat e specifikuar në nenin 241 të KPP-së, është e pabazë.

4. Aktakuza duhet të hudhet pjesërisht sepse e ngarkon të pandehurin për të njëjtin veprim penal me disa vepra penale (mbrojtja e F.L.)

Parashtresa e palëve

111. Mbrojtja e F.L. kërkon që aktakuza të hudhet pjesërisht sepse e ngarkon të pandehurin për të njëjtin veprim penal me disa vepra penale (Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe Marrjes së ryshfetit). Bazuar në teorinë e marrëveshjes, në veçanti parimi i specialitetit (*lex specialis*), i pandehuri mund të konsiderohet penalisht përgjegjës për veprën penale të dhënies/marrjes së ryshfetit. Për të mëbshtetur këtë qëndrim, mbrojtja i referohet Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në rastin kundër *Uka et al.* Të datës 17 prill 2013.²⁶

112. PSRK nuk u përgjigj në lidhje me këtë çështje të veçantë.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykues

113. Së pari, pranueshmëria e kërkesës duhet të adresohet për shkak se hudhja e aktakuzës është e kufizuar në bazat e cekura në nenin 250 (1) dhe ripohuar në nenin 253 (1) të KPP-së. Kodi nuk parashikon në mënyrë të qartë zbatueshmërinë e parimit të *lex specialis*, përdorim apo bashkëveprim si rrethana ekzistimi i të cilave do të arsyetonte hudhjen e aktakuzës.

²⁶ Shih parashtresën e mbrojtjes paras. 22 et seq. dhe para. 119; Gjykata e Apelit, Aktvendimi mbi ankesën, PN 230/130 (“Rasti i tokës”), 17 prill 2013.

Megjithatë, sipas mendimit të Kryetaressë Trupit Gjykues, çështja e bashkimit të veprave penale mund të shihet si pjesë e një vlerësimi më të gjerë, ndërsa ekziston dyshimi i bazuar mirë në lidhje me veprat penale të pretenduara (neni 250 (1.4) i KPP-së). Nëse, për shembull, njëra nga veprat penale është përdorur qartazi nga tjetri apo nëse zbatohet parimi i specialitetit, dyshimi i bazuar mirë duket të jetë i vështirë të konfirmohet për këtë vepër penale. Kjo gjetje mbështetet më tej nga neni 253 (2) i KPP-së dhe prandaj, kërkesa konsiderohet e pranueshme.

114. Çështja në fjalë është qoftë akuzë përmbledhëse që lejohet sipas kornizës ligjore të KPP-së. Pas shqyrtimit të jurisprudencës ekzistuese deri më tani, disa nga gjykatat themelore duket të analizojnë aktakuzën duke aplikuar parimet që udhëheqin bashkimin e veprave penale në aktakuzë dhe fazën e deklarimit rreth fajësisë²⁷, ndërsa gjykatat tjera themelore kanë konfirmuar aktakuzën pa iu adresuar kësaj çështjeje fare. Gjykata e Apelit, ashtu siç mbrojtja thekson në mënyrë të drejtë në parashtresën e saj, ka zbatuar parimin e *lex specialis* në aktakuzë dhe fazën e deklarimit rreth fajësisë dhe hudhi njërën nga akuzat e aktakuzës në rastin *Uka et al.* Gjykata konsideroi në këtë rast, se prokurori në mënyrë efektive ka ngarkuar të pandehurit për të njëjtin aktivitet penal me dy vepra penale dhe gjeti se “kualifikimi ligjor kumulativ për të njëjtin veprim të pretenduar përbën një gabim në ligj”.²⁸ Megjithatë, Gjykata e Apelit vërejti gjithashtu se kualifikimet ligjore të përcaktuara nga Prokurori Special dhe nga kolegjet e ankesave nuk janë detyruese për trupin gjykues, i cili vetëm pas një vlerësimi dhe përcaktimi të plotë të situatës faktike do të përcaktojë kualifikimin ligjor për veprën penale përkatëse.²⁹ Kohëve të fundit, Gjykata e Apelit e la të hapur çështjen e akuzës kumulative. Ajo konsideroi se:

“Kryetari i Trupit Gjykues në aktvendimin e tij taken ka vendosur të hudh akuzat kur vepra tanimë është mbuluar nga një akuzë tjetër në aktakuzë. Gjykata e Apelit nuk gjen asnjë arsye të kundërshtojë këtë qasje, por e gjen të panevojshme. Në pajtim me nenin 253 paragrafin 2 Kryetari Trupit Gjykues nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë dhe më tej në pajtim me nenin 360 paragrafin 2 gjatë marrjes së aktgjykimit gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës. Prokurori ka

²⁷ Shih psh. Gjykata Themelore e Prishtinës, PKR. Nr. 1046/13 (“Pasaporta”), Aktvendim mbi kërkesat për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet ndaj provave, 3 shkurt 2014.

²⁸ Gjykata e Apelit, PN 240/2013, Aktvendim mbi ankesën, 17 prill 2013, paras. 55 et seq.

²⁹ Ibid, para. 66.

zgjedhur që në aktakuzën e tij të përshkruajë veprimet që të pandehurit pretendohet të kenë kryer dhe i akuzoi ata me çdo vepër penale që do të mund të mbulonte veprimet e kryera, edhe pse është e qartë se të akuzuarit nuk mund të akuzohen për disa vepra të ndryshme penale për të njëjtin veprim, përveç nëse lejohet sipas rregullave mbi bashkëveprimin. Pa marrë parasysh se si e ka formuluar aktakuzën Prokurori, do të jetë trupi gjykues që do të vendosë se cilat veprime janë vërtetuar përtej dyshimit të bazuar, si do të kualifikohen veprimet e kryera dhe për cilat vepra penale do të dënohet i akuzuari. Prandaj, Gjykata e Apelit nuk do të elaborojë më tej rreth këtyre rregullave mbi bashkëveprimin në mes të akuzës së Mashtrimit dhe akuzës Shkeljes së besimit.”³⁰

115. Pra, Gjykata e Apelit nuk duket të ketë një qëndrim të prerë lidhur me çështjen e akuzës kumulative/përmbledhëse; thjesht është lënë në zgjedhje të Kryetares së Trupit Gjykues, nëse ajo dëshiron të merret me këtë çështje fazës së aktakuzës dhe të deklaramit rreth fajësisë apo jo. Është vërejtur se praktika e akuzës kumulative është pranuar gjerësisht nga organet ndërkombëtare penale me arsyetimin se, para shqyrtimit gjyqësor, mund të mos jetë e mundur që të përcaktohet se cilat akuza do të provohen përtej dyshimit të arsyeshëm.³¹

116. Megjithatë, një praktikë e ndryshme në zhvillim priret theksimit të pengesave që akuza kumulative/përmbledhëse mund t’i shkaktojë mbrojtjes dhe të drejtës për një gjykim të drejtë. Gjykata Penale Ndërkombëtare kohëve të fundit ka vendosur që “praktika ndjekëse e akuzës kumulative/përmbledhëse është në dëm të të drejtave të mbrojtjes, pasi që vendos një barrë të panevojshme në mbrojtje”.³² Tutje, “si çështje e drejtësisë dhe ekspeditimit të procedurës, vetëm krimet e dallueshme mund të arsyetojnë qasjen kumulative/përmbledhëse të akuzës dhe, prfundimisht të konfirmohen si akuza”. Gjykata theksoi mundësinë që gjyqtarët “të ri-karakterizojnë një krim për t’i dhënë atij karakterizimin më të përshtatshëm ligjor” kur konstatohet se nuk ka nevojë për një qasje të akuzës kumulative/përmbledhëse në mënyrë që prokuroria të sigurohet se së paku njëra nga akuzat do të mbahet nga gjykata.

³⁰ Gjykata e Apelit, PN 97/14 (“Pasaporta”), Aktvendim mbi ankesat, 27 mars 2014, paras. 14 dhe 15.

³¹ ICTY, *Prokurori v. Delalić, et al.*, Ankesat Aktgjykimi i Odës/Gjykatës, Rasti Nr. IT-96-21-A, 20 shkurt 2001, para. 400; SCSL, *Prokurori v. Sesay et al.*, Ankesat Aktgjykimi i Odës/Gjykatës, Rasti Nr. SCSL-04-15-A, 26 tetor 2009, para. 1192.

³² ICC, *Prokurori v. Jean-Pierre Bemba*, Vendim në pajtim me nenin 61 (7) (a) dhe (b) të Statusit të Romës mbi akuzat e Prokurorit kundër Jean-Pierre Bemba Gombo, 15 qershor 2009, paras. 200 et seq; Qasje e njëjtë është miratuar nga Gjykata e Ankesës e Tribunalit Special për Libanin, Vendim i Përkohshëm mbi Ligjin e zbatueshëm, Rasti Nr. STL-11-01/I/AC/R176bis, 16 shkurt 2011, para. 298.

117. Kryetarja e Trupit Gjykses vëren se në procedurën penale paralele, në rastin P 8/13 (MTPT 1), aktakuza është konfirmuar në lidhje me të dyja veprat penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe Marrjes së ryshfetit. Edhe pse në atë rast asnjë kërkesë për hudhje të aktakuzës nuk është mbështetur në argumentin e bashkëveprimit, për të siguruar koherencë në rastin në fjalë – në veçanti duke patur parasysh një bashkim të mundshëm në një fazë të mëvonshme – Kryetarja e Trupit Gjykses vie në përfundim se kërkesa e Mbrojtjes për të hudhur aktakuzën mbi këtë arsytim, duhet refuzuar si e pabazuar.

5. *Gjetjet e aktakuzës në shkelje të parimit ne bis in idem (rrezik i dyfishtë)*

Parashtrësas e palëve

118. Mbrojtja e F.L. kërkon të hudhet aktakuza për arsye se i pandehuri veçmë është akuzuar me Aktakuzën PPS 425/09. Është parashtruar se parimi *ne bis in idem* mbulon jo vetëm situatën e lirimit apo të dënimit me vendim përfundimtar, por gjithashtu situatën kur i akuzuari akuzohet për më shumë se një vepër penale për të njëjtat vepra penale (neni 250 (1.3) i KPP-së).

119. Prokuroria nuk u përgjigjën ndaj kësaj çështjeje të veçantë.

Ligji i zbatueshëm

120. Ttë dyja, garancitë kushtetuese si dhe ligji i zbatueshëm drejtpërdrejtë ndërkombëtar dhe European i të drejtave të njeriut, parandalojnë të pandehurin që të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër apo akt penal.

121. Neni 4 (1) i KPP-së parasheh si në vijim:

“Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës”

122. Formulimi i nenit 4 (1) të KPP-së (“vepër penale”) mund të sugjerojë se është më tepër klasifikim ligjor i akuzave të cilat janë vendimtare për vlerësimin e fushëveprimit të

zbatueshëm të *ne bis in idem*. Megjithatë, një lexim sistematik i KPP-së dhe shqytimit të sistemeve të zbatueshme të të drejtave njerëzore kushtetuese dhe Europiane, çojnë në përfundim se termi “vepra të njëjta penale” mund të kuptohen si të lidhura me të njëjtat fakte ose sjellje dhe jo klasifikimin e tyre në ligj. Vet KPP parasheh në nenin 363 (1.2) se gjykata merr aktgjykim me të cilin refuzohet akuza, nëse “i akuzuari për të njëjtën vepër është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë ose procedura kundër tij është pushuar me aktvendim të formës së prerë.”

123. Përveç kësaj, neni 34 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh se “*askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale*”. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) ka interpretuar nenin 4 të Protokollit Nr. 7 të KEDNj-së si “ndalimi i ndjekjes ose gjyqimit të një “vepre” të dytë, deri sa ajo lind nga faktet e njëjta apo faktet që janë thelbësisht të njëjta”.³³ Tutje, GjEDNj ka sqaruar se “hetimi i Gjykatës duhet të përqëndrohet në ato fakte të cilat përbëjnë një grup të rrethanave konkrete faktike, përfshirë të njëjtin të pandehur dhe lidhur ngushtë së bashku në kohë dhe hapësirë, ekzistenca e të cilave duhet të tregohet në mënyrë që të sigurohet një dënim apo themelim i procedurës penale”.³⁴ Prandaj, Gjykata mori qëndrim se neni 4 i Protokollit Nr. 7 duhet të kuptohet si ndalim i ndjekjes apo gjyqimit të një vepre të dytë, deri sa ajo lind nga faktet e njëjta apo faktet që janë thelbësisht të njëjta. Hetimi i Gjykatës duhet të përqëndrohet në ato fakte të cilat përbëjnë një grup të rrethanave konkrete faktike, përfshirë të njëjtin të pandehur dhe lidhur ngushtë së bashku në kohë dhe hapësirë, ekzistenca e të cilave duhet të tregohet në mënyrë që të sigurohet një dënim apo themelim i procedurës penale.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

124. Kërkesa e bërë nga Mbrojtja është e pranueshme pasi që është brenda kuadrit të nenit 250 (1.3) të KPP-së. Termi “rrethana që ndalojnë ndjekjen” përfshin parimin e *ne bis in idem* siç është përcaktuar në nenin 4 të KPP-së.
125. Kryetarja e Trupit Gjykses gjen bindës arsyetimin e GjEDNj-së në *Sergey Zolotukhin v. Russia* dhe ai duhet të ndiqet në rastin aktual. Për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me “vepër të njëjtë penale”, duhet të merret parasysh nëse vepra penale del nga faktet e njëjta

³³Zolotukhi v. Russia, Aktgjykimi [GC](nr. 14939/03), 10 shkurt 2009 para. 82.

³⁴Ibid., para. 84

apo faktet që janë thelbësisht të njëjta; klasifikimi ligjor i veprimeve të tilla nga Prokuroria është irrelevant.

126. Situata faktike dhe ligjore në rastin aktual nuk bie brenda nenit 4 të KPP-së. Të pandehurit F.L. dhe N.K., të dytë subjekt i procedurës penale në P 8/13 (MTPT 1) dhe PKR 84/18 (MTPT 2), nuk janë liruar apo dënuar për veprat me të cilat akuzohen në Aktakuzën PPS 67/10. Procedura penale kundër F.L.t në të ashtuquajturin *Rasti Kleçka* (P 766/12) ishte bazuar në pretendime tjera faktike dhe ligjore. Gjithashtu, fakti që akuzat e Aktakuzës PPS 425/09 (P 8/13) janë hudhur pjesërisht me Aktvendimin e Kryetares së Trupit Gjykses, e që janë mbështetur nga Gjykata e Apelit, nuk shkaktojnë parimin e *ne bis in idem*. Kryetarja e Trupit Gjykses nuk duhet të vendosë mbi fajshmërinë e të akuzuarve në këtë fazë të procedurës, dhe i pandehuri vazhdo të konsiderohet i pafajshëm deri sa fajësia e tij të jetë provuar me vendimin e formës së prerë *res judicata*. Gjetja e dyshimit të bazuar mirë për veprat penale të ngarkuara nuk është gjetje e fajësisë.

6. Dyshimi i bazuar mirë për veprën penale të Krimin të organizuar (Pika 1) kundër F.L.t, N.K.t dhe S.T.

127. F.L., N.K. dhe S.T. akuzohen për veprën penale të Krimin të organizuar, në shkelje të nenit 274 paragrafit 3 lexuar së bashku me paragrafin 1 të KPK-së së vjetër dhe e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet, lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së së vjetër.

128. Siç pretendohet nga Prokurori, nga viti 2008 deri më vitin 2012 në Kosovë, të pandehurit kanë vepruar si anëtarë të një grupi të organizuar, që kanë kryer krime serioze siç është specifikuar në aktakuzë (Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës; Lidhja e kontratës së dëmshme; Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar; Marrja e rryshfetit). Sipas Aktakuzës, qëllimi i këtij grupi ishte të jepnin tenderë fitimprurës për ndërtimin e rrugëve, respektivisht mirëmbajtjen e rrugëve, kompanive për ndërtimin e rrugëve në bazë të vlerësimeve politike dhe në sajë të pagesave stimuluese në para të gatshme. Grupi kriminal pretendohet se ishte i strukturuar dhe anëtarët e tij kanë vepruar së bashku në një periudhë të konsiderueshme kohore. Anëtarët e grupit kishin lidhje familjare apo miqësore me F.L., i cili shërbeu si kreu i grupit.

Parashtrësit e palëve

129. Në përgjithësi, mbrojtësit e të gjithë të pandehurve të akuzuar me këtë veprë penale kanë kërkuar që të hudhet kjo akuzë, sepse nuk kishte kurrfarë prove se ekzistonte një grup i strukturuar kriminal i organizuar. Më tej, Mbrojtja paraqet se Prokuroria nuk arriti të vërtetojë elementet tjera të nevojshme të veprës penale të krimit të organizuar, identifikuar në parashtrësën e mbrojtjes si në vijim:

- secili anëtar i organizatës kriminale ka detyrëne tij/saj të caktuar paraprakisht dhe rolin e tij/saj në kryerjen e veprës penale,
- aktiviteti i organizatës kriminale është planifikuar për të vepruar për një kohë të gjatë apo një periudhë të pacaktuar kohore,
- aktiviteti i organizatës kriminale bazohet në zbatimin e disa rregullave të kontrollit dhe disiplinës së brendshme të anëtarëve,
- aktiviteti i organizatës kriminale planifikohet të kryhet ndërkombëtarisht,
- për kryerjen e veprës penale të dhunës, frikësimit apo gatishmërisë për kryerjen e tij duhet të tregohet,
- për kryerjen e aktiviteteve kriminale politike, ekonomike apo struktura të tjera janë përdorur,
- të kenë ndikimin e organizatës apo një pjese të saj në legjislativ, media, gjyqësor apo kompetencat ekzekutive etj.

130. Mbrojtja e F.L. ngriti argumentin se se ai nuk ka patur autoritet vendim marrës mbi anëtarët e grupit të organizuar kriminal të pretenduar, në veçanti nuk është vërtetuar se F.L. ka mbajtur ndonjë lloj përgjegjësie në lidhje me procedurat e tenderimit dhe dhënien e kontratave operatorëve ekonomik. Tutje, mbrojtja paraqet se procedurat e prokurimit janë rregulluar me Ligjin mbi Prokurimin Publik (LPP), ndërsa menaxhimi i financave publike është rregulluar me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Në pajtim me këto rregulla, ministrat e asnjë ministrie, pra as i pandehuri F.L., nuk kanë patur ndonjë kompetencë apo përgjegjësi në lidhje me procedurat e prokurimit ose menaxhimin të financave publike. Fakti se F.L. ishte Ministër i MTPT-së nuk nënkupton se ai duhet të mbajë ndonjë përgjegjësi për ndonjë parregullsi eventuale që ka mundur të ketë ndodhur në lidhje me procedurat e prokurimit. Prokuroria ka vlerësuar dhe matur gabimisht provat kundër të pandehurve, në veçanti raportin e ekspertit të përgatitur nga ekspertët ndërombëtarë Lothar Mewes dhe Klaus Groth dhe deklaratat e dhëna nga dëshmitarët B.R. dhe V.K.

131. Mbrojtja e S.T. kundërshtoi gjithashtu akuzën e Krimit të organizuar dhe kërkoi hudhjen e saj bazuar në argumentin se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë (neni 250 (1.4) i KPP-SË). Në veçanti, siç argumenton mbrojtja, nuk ka asnjë provë që kërkesat në vijim për një vepër penale të jenë përmbushur: “tre apo më shumë anëtarë të grupit; qëllimi i grupit për të kryer vepra penale; struktura organizative e vendim marrjes; ndarja e roleve”. Tutje, Mbrojtja paraqet se nuk ka asnjë provë për të mbështetur pretendimet se i pandehuri Telaku ka organizuar negociata private në mes të F.L.t dhe kompanive të interesuara për fitimin e tenderëve për ndërtimin e rrugëve.
132. Prokuroria argumentoi, *në mes tjerash*, se: (i) janë mbledhur prova të mjaftueshme për të siguruar dënimet; (ii) ndikimi i argumentuar i F.L.t nuk është bazuar në pozitën e tij si ministër, por më parë në kompetencën dhe ndikimin e tij që ai ka përdorur në MTPT në fushat që nuk ishin nën mbikqyrjen e tij të drejtëpërdrejtë; dhe (iii) provat duhet të analizohen së bashku dhe jo në mënyrë të izoluar. Prokuroria përsërit shumicën e pretendimeve faktike të paraqitura në aktakuzë.
133. Mbrojtja e N.K. dhe vet i pandehuri kërkuan hudhjen e aktakuzës mbi këto baza: (i) nuk ka prova të mjaftueshme që do të mbështesnin kryerjen e veprave penale nga ai, në kundërshtim me nenin 241 të KPP-së; (ii) Prokuroria nuk ka mundur të vërtetojë bashkë-kryerjen në mes të pandehurve; dhe (iii) aktakuza nuk mund të mbështetet në supozime dhe Kryetarja e Trupit Gjykes duhet të vendosë *in dubio pro reo*.
134. Prokuroria kundërshtoi qëndrimin e Mbrojtjes së N.K., duke argumentuar se parashtrësia përbën pohime dhe konkluzione të pasqaruara dhe prandaj është e pamundur për Prokurorinë që të bëjë komente të mëtejme apo t’i përgjigjet pohimeve të tilla të paarsyetuara.

Ligji i zbatueshëm

135. Neni 274 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së së vjetër (zbatuar nga Prokurori në Aktakuzë) përcakton:

“(1) Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet.

(3) Kushdo që organizon, formon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobën deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.”

Definicionet e nevojshme ligjore gjenden në paragrafin 7 të këtij neni që lexon:

“Për qëllime të këtij neni,

- 1) Shprehja “krim i organizuar” do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare.*
- 2) Shprehja “grup kriminal i organizuar” do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtëpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare.*
- 3) Shprehja “krim i rëndë” do të thotë vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet.*
- 4) Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale dhe nuk do të thotë formalisht t’i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.”*

136. Krimi i organizuar për ekzistimin e tij kërkon kryerjen e një vepre penale ‘themelore’. Formulimi i përdorur gjatë tërë nenit 274 të KPK-së së vjetër përcakton se kryerja e një vepre bazë është një element përbërës për këtë vepër penale. Përndryshe, një person mund të shpallet fajtor për të njëjtën vepër, që bënë pjesë në të dyja veprat penale, të krimit të organizuar dhe të veprës themelore.³⁵

137. Sa i përket elementeve materiale të veprës së krimit të organizuar, kryesi i veprës penale duhet të organizojë, themelojë, mbikëqyrë, menaxhojë apo drejtojë aktivitetet e grupit të organizuar (d.m.th., tre apo më shumë persona) i cili ekziston për një periudhë kohore dhe që vepron në bashkëpunim. Elementi subjektiv i veprës penale është qëllimi i kryerjes së një apo më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë pasurore ose financiare. Paragrafi 7(4) i nenit 274 e bënë të qartë se

³⁵ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 61/2012, Aktgjykimi, 2 tetor 2012.

brenda “grupit të strukturuar” nuk do të thotë formalisht t’i ketë të përcaktuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

138. Argumentet e mbrojtjes janë refuzuar si të pabaza. Në kundërshtim me pohimet e mbrojtjes, sipas KPK-së së vjetër nuk ka asnjë kërkesë të hierarkisë së qartë në mes të anëtarëve të grupit, disiplinës rigoroze, bindjes dhe besnikërisë, përshtatshmërisë dhe shkathtësisë në kryerjen e veprës penale. Për një grup të strukturuar, mjafton që të jenë tre apo më shumë anëtarë në grup, i cili nuk është formuar rastësisht.

139. Gjatë shqyrtimit gjyqësor Trupit Gjykses do të ketë mundësinë të shqyrtojë me kujdes provat dhe të përcaktojë nëse F.L., N.K. dhe S.T. kanë formuar një grup të strukturuar dhe çfarë roli, (nëse kanë patur ndonjë) ka luajtur secili i pandehur (psh., në organizim, mbikëqyrje, menaxhim, etj.). Për momentin, provat e paraqitura nga Prokuroria janë të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin e bazuar mirë se F.L., N.K. dhe S.T. kanë formuar një grup (tre persona) që ka ekzistuar për një periudhë kohore (periudha kohore e aktakuzës), nuk kanë vepruar në bashkëpunim rastësisht, dhe kanë patur për qëllim kryerjen e një krimi të rëndë. Siç paraqitet nga Prokuroria, provat duhet të vlerësohen si tërësi dhe për momentin prova siç është dëshmia e S.T. në procedurë paraprake, përgjimet e telekomunikimeve, dokumentet që kanë të bëjnë me procedurën e prokurimit, dhe provat tjera të dokumentuara, mbështesin konkluzionin e dyshimit të bazuar mirë kundër të pandehurve. Gjithashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor, Trupit Gjykses do të vërtetojë nëse janë kryer veprat penale themelore të Krimit të organizuar.

140. Në lidhje me raportin e ekspertit të përgatitur nga ekspertët ndërkombëtarë Lothar Mewes dhe Klaus Groth dhe deklaratat e dhëna nga dëshmitarët B.R. dhe V.K., Kryetarja e Trupit Gjykses pranon se këto pjesë të provave kanë një vlerë të padiskutueshme provuese, pasi që ato janë relevante për rastin, por pesha që do u jepet atyre mbetet të shqyrtohet gjatë shqyrtimi gjyqësor. Vlerësimi i Trupit Gjykses për peshën e duhur të tyre mund të bëhet pasiqë provat të jenë testuar dhe të jenë paraqitur gjatë gjykimit.

7. Dyshimi i bazuar mirë për veprën penale të Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 2)

141. Të pandehurit F.L., N.K. dhe S.T. janë të akuzuar për kryerjen e veprës së Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës, në kundërshtim me nenin 340, paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së së vjetër dhe e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vjet, të lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkë-kryerja) sa i përket F.L. dhe N.K.; tutje lexuar së bashku me nenin 25 të KPK-së (ndihma) sa i përket S.T.
142. Prokurori pohon se në vitet 2008 dhe 2010 në Kosovë, F.L. dhe N.K. në detyrat e tyre zyrtare si Ministër i MTPT-së dhe Shef i Prokurimit të MTPT-së administruan shfrytëzimin e buxhetit të MTPT-së. Ndërsa F.L. mbajti përgjegjësinë kryesore të buxhetit, N.K. e bëri të mundur shfrytëzimin e buxhetit të caktuar duke i nënshkruar kontratat ligjërisht të detyrueshme me kompanitë *E.* dhe *B.* për tenderët me udhëzimin e F.L. I pandehuri S.T. dyshohet të ketë ndihmuar F.L. dhe N.K. në marrëveshjet private duke bërë negociata, në dorëzimin e dokumenteve të tenderëve dhe në bartjen e komunikimeve që vinin nga F.L. dhe që i drejtoheshin atij, para dhe gjatë kohës që procedura e tenderit ishte në vazhdim e sipër. Realizimi i kontratave krijoi kërkesa ligjërisht të detyrueshme civile kundër buxhetit të MTPT-së dhe çoi tek ekzekutimi i kërkesave dhe pagesave të Ministrisë së Financave.
143. Më tej, Prokurori pohon se të pandehurit e përvetësuan buxhetin financiar të MTPT-së gjatë kryerjes së detyrave të tyre, që në mënyrë të pandërgjegjshme e zbatuan buxhetin në shfrytëzimin e tyre për nevojat personale duke i zgjedhur tenderët *E.* dhe *B.*, me një proces të përzgjedhur dhe të manipuluar në shkëmbim të parave të rryshfetit. Përfitimet materiale të marra nga këto kompani tejkalojnë kufirin prej 5.000 Eurove, limit i paraparë me nenin 340, paragrafin 3 të KPK-së.

Parashtrësat e Palëve

144. Mbrojtja e F.L., N.K. dhe S.T. kërkon të hudhet kjo akuzë e aktakuzës, duke iu referuar vendimit përfundimtar të Kryetares së Trupit Gjykses në rastin MTPT 1.
145. Prokurori nuk iu adresua argumenteve të paraqitura nga mbrojtja dhe mbështeti akuzën e Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës.

Ligji në fuqi

146. Dispozitat e nenit 340 të KPK-së të zbatuara në Aktakuzë nga Prokurori, cekin si në vijim:

(1) Personi zyrtar që përvetëson para, letra me vlerë ose pasuri tjetër të luajshme që i është besuar personit në bazë të detyrës së tij ose pozitës brenda një organi publik ose personi juridik, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 EUR, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

147. “Për të përvetësuar” ka kuptim për të marrë në posedim ose në përdorim në mënyrë ekskluzive për veten, shpesh pa autorizim. Prona i është besuar dikujt në qoftë se i është dhënë në përkujdesje, mbrojtje, ose kryerje.

148. Për të i vlerësuar si duhet bazat e akuzës është e domosdoshme që të bëhet referimi në fushëveprimin e detyrave dhe kompetencave të të pandehurve si Ministër i Transportit dhe Telekomunikacionit (F.L.) dhe të Shefit të Prokurimit (N.K.) në lidhje me buxhetin.

149. Detyra e ministrave është e përcaktuar në tërësi në *Kushtetutën e Republikës të Kosovës, me Rregulloren Nr. 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë* (që ka qenë në fuqi deri në muajin tetor 2010) dhe në Ligjin Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (hyrë në fuqi nga muaji tetor 2010).

150. Sipas nenit 1.3 të *Rregullores mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë* secili ministër, në pajtim me politikën e përcaktuar nga Qeveria:

- a) Udhëheq dhe përfaqëson Ministrinë e tij apo të saj ;
- b) I përgjigjet Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me Ministrinë e tij apo të saj;
- c) Përcakton orientimin politik të punës së Ministrisë;
- d) Nxjerr vendime dhe udhëzime administrative në mënyrë që t’i rregullojë aktivitetet e Ministrisë në përgjithësi ose në fushat e veçanta të Ministrisë;
- e) Kryen detyra të tjera në suaza të kornizës së përgjegjësive të Ministrisë të përcaktuara me ligj dhe
- f) I raporton Kuvendit në pënyrë periodike, dhe me kërkesë të Kuvendit, raporton për aktivitetet e Ministrisë, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha fondeve të pranuar.

151. Siç është paraparë me nenin 1.7 b të *Rregullores*, gjatë kryerjes së përgjegjësive dhe funksioneve të tyre, Ministrat do të kujdesen që Ministrinë e tyre përkatëse të djekin

shpërndarjen më të përshtatshme, me kosto efektive, transparente dhe të përgjegjshme të fondeve që merren nga Buxheti për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe burimet tjera;:

152. Posti i Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit tutje ishte rregulluar në Shtojcën VIII të Rregullores , dhe dispozita e saj (ix) përcakton se ai do të :

“në sektorin e infrastrukturës rrugore zhvillon programe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike, siguron financimin dhe organizon dhënien e koncesioneve sipas nevojës; mbikëqyr financimin dhe menaxhimin e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë edhe kryerjen e punëve teknike, organizative dhe zhvillimore përkitazi me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike, kontrollojnë gjendjen e rrugëve, si dhe mirëmban dokumentacionin për rrugët publike dhe trafikun rrugor;

153. Ligji më domethënës në Kosovë duke ndikuar në kontrollin publik të brendshëm financiar është *Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi* (Ligji Nr. 03/L—048). Ky ligj mbulon marrëveshjet për zhvillim të buxhetit dhe proceseve të miratimit të tij, duke përfshirë proceset parlamentare, sikurse edhe marrëveshjet për transfere dhe për prezantimin e të ardhurave për buxhetin. Ligji poashtu, përkufizon “ paratë publike”, organizimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe caktimin e zyrtarëve kryesorë, kapitalit dhe shpenzimeve të operimit, menaxhimit financiar, llogaritjen, llogaridhënien e buxhetit, dhe prezantimin e sistemeve financiare për autoritetet publike dhe ndërmarjet publike në Kosovë; përshkruan funksionet dhe detyrat e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe të autoriteteve të tjera publike që merren me këto çështje.

154. Ligji sipas nenit 1.1 përkufizon “ organizatë buxhetore” do të thotë një autoritet ose ndërmarrje publike e cila drejtpërdrejtë pranon një ndarje buxhetore sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, ndarje buxhetore kjo që nuk është pjesë e një ndarjeje tjetër të përgjithshme buxhetore e cila i është bërë një autoriteti ose ndërmarrjeje tjetër publike. Poashtu përshkruan strukturën administrative që organizatat buxhetore të të gjitha llojeve duhet të themelojnë që të sigurojnë rregullimet e duhura të menaxhimit financiar. Kjo strukturë përfshin zyrtarin kryesor administrativ (i cili është zyrtar kryesues), një auditor të brendshëm, një zyrtar kryesor financiar, oficerin e prokurimit, dhe zyrtarin Çertifikues. Ligji, poashtu specifikon marrëveshjet për pranimin e kostos së shpenzimeve të parave publike për xhirollogaritë brenda Fondit të Kosoliduar të Kosovës. Pjesa VIII e këtij Ligji paraqet kushtet për raportim, llogaritje, kontroll të

auditimit financiar, përfshirë një kërkesë për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që të përgatisë një sistem të klasifikimit të buxhetit dhe një skemë të llogarive duke i aplikuar standardet e dala nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve-FNK.

155. 10.1. Posti i zyrtarit kryesor administrativ rregullohet me nenin 10 i cili përkufizon:

10.1

Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësinë kryesor ligjore për të siguruar që organizata buxhetore (.....) dhe personeli i saj të jenë në përputhshmëri të plotë si dhe të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji dhe rregullat e KMF.

10.2

Zyrtari Kryesor Administrativ, ndër të tjera është shprehimisht përgjegjës për:

- a) Vendosjen e kontrolit të brendshëm financiar në organizatën buxhetore, agjencinë autonome ekzekutive ose ndërmarjen publike sipas Rregullave të KMF;*
- b) Delegimin e funksioneve për mbledhjen dhe shpenzimin e parave publike në pajtim me Rregullat e KMF;*
- c) Vendosjen e një kornize për vlerësimin dhe menaxhimin e performancës së personelit të organizatës buxhetore të cilave u janë deleguar funksionet e tilla;*
- d) Vendosjen dhe zbatimin e masave të brendshme disiplinore për tu zbatuar në raste kur personeli nuk i ushtron funksionet e deleguara në mënyrë adekuate apo të rregullt; dhe*
- e) Njoftimin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjitha rastet ku me arsye dyshohet se ka pasur shkelje – nga një person ose ndërmarrje – të këtij ligji, Rregullave të KMF ose ndonjë ligji tjetër.*

156. Siç është paraparë me nenin 12 (1) të Ligjit secila organizatë buxhetore do të ketë Zyrtarin Kryesor Financiar. Detyrat dhe kompetencat e tij më tutje shtjellohen në paragrafët 4 dhe 5 të rastit në fjalë) i cili lexohet si në vijim:

(4) Çdo ZKF është përgjegjës për veprimtarinë e rregullt dhe të ligjshme financiare të organizatës buxhetore përkatëse, agjencisë autonome ekzekutive ose ndërmarrjes publike.

(5) Për organizatën buxhetore ose agjencinë autonome ekzekutive, ZKF është i autorizuar dhe përgjegjës për:

(i) përgatitjen e propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore të organizatës përkatëse buxhetore apo agjencisë autonome ekzekutive;

(ii) të sigurojë që të gjitha transaksionet të regjistrohen në Regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit;

(iii) të sigurojë që të gjitha faturat e rregullta të pranuar nga organizata buxhetore të dorëzohen menjëherë për pagim përmes sistemit të thesarit;

(iv) mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve të raportimit buxhetor; dhe

(v) ushtrimin e të gjitha funksioneve që i janë dhënë ZKF-së sipas Rregullave KMF. Të gjitha detyrat e ZKF-së duhet të jenë në përputhje të plotë me Rregullat KMF.

157. Në përputhje me nenin 13.1 çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të kenë Zyrtarin e Prokurimit, i cili do të jetë përgjegjës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit të organizatës buxhetore në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik.

158. Siç rezulton nga neni 34.1 Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore do të informojë Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit;

i) për çdo kontratë të lidhur nga organizata buxhetore dhe për çfarëdo ndryshimi të ndonjë kontrate të lidhur më parë nga organizata buxhetore, nëse kontrata e tillë e obligon organizatën buxhetore që të bëjë pagesa gjatë vitit fiskal aktual apo gjatë viteve të ardhshme fiskale, dhe

(ii) për të gjitha obligimet jashtë-kontraktuese për pagesë të organizatës buxhetore sipas paragrafit 3 të këtij neni.

159. Rregullat e pagesës përshkruhen në nenin 38 dhe 39 të ligjit:

38.1 Nuk do të lejohen kurrfarë mjetes nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për bërjen e pagesave kur nuk ekziston një njoftim aktual për alokimin e fondeve me anë të të cilit autorizohet përdorimi i të hollave për bërjen e pagesave të tilla.

38.2 Procesi i cili do të ndiqet për bërjen e pagesave të autorizuara nga njoftimi për alokimin e fondeve, do të vendoset nga Rregullat e KMF.

39.1 ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

39.2 Kur një person ka lëshuar një faturë ose kërkesë për pagim për një organizatë buxhetore dhe shuma në fjalë nuk është paguar për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë, personi në fjalë mundet ta dorëzojë një kopje të faturës ose kërkesës për pagim në Thesar. Pas pranimit të kopjes së faturës ose kërkesës për pagim, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, brenda tridhjetë (30) ditëve të ardhshme, do të bëjë një hetim në organizatën buxhetore për të vërtetuar nëse (i) fatura ose kërkesa për pagim është e vlefshme dhe se mallrat dhe shërbimet janë furnizuar ose punët janë realizuar, dhe (ii) shuma përkatëse nuk është paguar nga organizata buxhetore për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë. Nëse rezultati i hetimit del të jetë pozitiv, Thesari do e paguajë shumën në fjalë pa pasur nevojë të marrë miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore. Në raste të këtilla, Thesari është i autorizuar që të ekzekutojë një njoftim për bartjen e shpenzimit pa miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore.

Konstatimet e Gjykatës

160. Analiza e rrethanave të rastit çon në përfundimin se F.L. dhe N.K. nuk kanë përvetësuar para nga buxheti i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit pasi që ata nuk e kanë marrë në posedim atë dhe nuk e kanë përdorur atë vetëm për veten e tyre. F.L. si Ministër në fakt ishte përgjegjës për përdorimin e duhur dhe shpenzimin përkatës të fondeve të cilat i takonin buxhetit të organizatës udhëheqës i së cilës ishte ai, sidoqoftë nuk ka kurrfarë prove se ai i ka përdorur paratë për vete. Prokurori nuk ka pretenduar se shpenzimi i përshkruar në Aktakuzë nuk është në pajtim me *Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë* dhe brenda kornizës organizative të paraparë me të. Në të kundërtën, shpenzimi është bazuar në kontratat ligjrisht të detyrueshme të lidhura në mes të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kompanive të cilat fituan tenderët për ndërtime përkatëse të rrugëve si rezultat i procedurës së prokurimit.

161. Prokurori duket se nuk e vëren se paratë e shpenzuara nga buxheti i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit ishte ndarë për ndërtimin e rrugëve dhe kjo punë është kryer nga kompanitë kontraktuese. Nuk ka asnjë provë të vetme se këto fonde janë keqpërdorur nga të pandehurit.
162. Sa i përket N.K., duhet të theksohet gjithashtu se ai ishte Shef i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Transportit dhe si i tillë ai ishte përgjegjës për zbatimin e drejtë të procedurave të prokurimit. Atij nuk i është ngarkuar asnjë fond i MTPT-së, prandaj ai edhe nuk ka mundur t'i përvetësojë ato.
163. Në këtë mënyrë Kryetarja e Trupit Gjykses vendos të hudh akuzën e Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës kundër F.L. dhe N.K. Si pasojë, kjo akuzë hudhet gjithashtu dhe për të pandehurin S.T., i cili akuzohet se ka ndihmuar këta të pandehur në kryerjen e krimit.
164. E njëjta akuzë kundër F.L. dhe N.K. (por në lidhje me kontratat tjera për ndërtimin e rrugëve) është përfshirë në aktakuzën në rastin MTPT 1. Nga arsyet e njëjta ligjore dhe faktike siç janë paraqitur më lart, akuza është hudhur. Vlen të theksohet se Prokurori nuk ka paraqitur ankesë kundër këtij vendimi të Gjyqtarës së Procedurës Paraprake.

8. Dyshimi i bazuar mirë për veprën penale të Lidhjes së kontratës së dëmshme kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 3)

165. Të pandehurit F.L., N.K. dhe S.T. akuzohen për veprën penale të Lidhjes së kontratës së dëmshme, në shkelje të nenit 237, paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së së vjetër, e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vjet, ku kryesit e veprës penale shkaktojnë dëm që tejkalon 100.000 euro, lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkë-kryerja) sa i përket F.L. dhe N.K. dhe nenit 25 të KPK-së së vjetër (ndihma) sa i pëket S.T..
166. Prokurori pretendon se N.K. lidhi kontratat për tenderët publik (tenderi nr. 08-006-511 dhe tenderi nr. 08-073-521) me kompanitë *E. Dhe B.* me qëllim të marrjes së përfitimit personal, nën presionin e ushtruar nga F.L.. S.T. i ka ndihmuara ata në marrëveshjet private përmes negociatave, në dorëzimin e dokumenteve të tenderëve dhe në bartjen e komunikimeve në mes të bashkëpunëtorëve të kompanisë dhe F.L. para dhe gjatë procedurës së tenderimit. Kontratat e lidhura ishin të dëmshme Kontratat e lidhura ishin të dëmshme sepse ato ishin kompani që

ofronin oferta më të lira, që përmbushnin kriteret formale në proceset përkatëse të ofertave të tenderëve dhe që ishin në gjendje të kryenin punën siç duhet.

167. Siaps mendimit të Prokurorit, dëmet e shkaktuara nga këto manipulime arrin së paku diferencën në ofertat e vendosura; nëse jo vlerën e përgjithshme të tenderëve në vlerë prej prej EUR 885.069,00 pasi që rrugët e ndërtuara kanë kërkuar punime të sërishme në to si dhe përsëritjen e ndërtimit të duhur të rrugëve.

Parashtrësat e palëve

168. Mbrojtja e F.L., N.K. dhe S.T. kërkon që të hudhet kjo akuzë. Referencë i është bërë nga Mbrojtja arsyetimit ligjor të vendimit përfundimtar të Kryetares së Trupit Gjykses në rastin MTPT 1, të datës 01 korrik 2013.
169. Prokurori nuk i është adresuar argumenteve të paraqitura nga mbrojtja dhe mbështeti akuzën e Lidhjes së kontratës së dëmshme.

Ligji i zbatueshëm

170. Pasi që gjatë procedurës penale kundër të pandehurve e drejta materiale është ndryshuar, për të vlerësuar akuzat Kryetarja e Trupit Gjykses ishte e obliguar të verifikonte cili ligj ishte më i favorshëm për kryerësin e veprës penale. Krahasimi i elementeve të veprës penale të Lidhjes së kontratës së dëmshme, në të dyja Kodet Penale (atë të përkohshmin dhe këtë të riun) çon në përfundimin se ligji më i favorshëm për të pandehurit është ligji i ri.
171. Në pajtim me nenin 291 të KPK-së së ri, vepra penale e lidhjes së kontratës së dëmshme mund të kryhet vetëm nga një person përgjegjës i cili ushtron veprimtari ekonomike dhe përmes aktiviteteve të tij/saj i shkakton dëme organizatës së biznesit.
172. Neni 120 (7) i KPK-së së ri, përcakton organizatën e biznesit si çdo person fizik apo juridik ose grup personash që merren me veprimtari ekonomike, siç përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin për Shoqëritë Tregtare (LIGJI NR. 02/L-123). Në pajtim me nenin 2 (2.1) "*Shoqëri Tregtare e Kosovës*" është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas këtij ligji, p.sh Ndërmarrjet individuale,

shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

173. KPK i vjetër, në nenin 237, paragrafin 1 parasheh një definicion ndryshe të veprës penale të Lidhjes së kontratës së dëmshme, pasi që kjo vepër penale mund të kryhet jo vetëm nga një përfaqësues apo një person i autorizuar i një organizate të biznesit, por gjithashtu nga një përfaqësues apo person i autorizuar i personit juridik. Prandaj, vargu i subjekteve të cilët kanë mundur të kryejnë këtë vepër penale ishte përfundimisht më i gjerë se ai që është dhënë në Kodin Penal aktual. Për më tepër, siç është paraparë me Kodin e mëparshëm, rezultati i veprimeve të ndërmarra nga këta persona duhet të jetë dëmi që do t'i shkaktohej jo vetëm një organizate të biznesit por gjithashtu dhe një personi juridik.
174. Duke patur parasysh atë që u tha më lart, Kryetarja e Trupit Gjykses është e mendimit se definicioni i veprës penale të Lidhjes së kontratës së dëmshme, siç parashihet në KPK-në e ri, është më i favorshëm për të pandehurit pasi që vargu i subjekteve që janë në gjendje për të kryer vepra të tilla dhe e palëve të mundshme të dëmtuara është padyshim më i ngushtë.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

175. F.L. dhe N.K. ishin duke shërbyer në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit si persona zyrtarë. Ata nuk ishin të angazhuar në aktivitete ekonomike, siç përcaktohet me nenin 291 të KPK-së së ri, dhe përmes veprimeve të tyre nuk i kanë shkaktuar ndonjë dëm organizatës së biznesit. Prandaj, ata nuk kanë mundur të kryejnë veprën penale të Lidhjes së kontratës së dëmshme, siç parashihet me nenin 291 paragrafin 1 të KPK-së së ri.
176. Pas shqyrtimit të asaj që u tha më lart, Kryetarja e Trupit Gjykses hodhi akuzën e Lidhjes së kontratës së dëmshme kundër F.L. dhe N.K. Pasi që i pandehuri S.T. akuzohet për asistimin e këtyre të pandehurve, rrjedhimisht akuza është hedhur poshtë edhe në lidhje me të.
177. Në rastin MTPT 1 F.L. dhe N.K. janë akuzuar për veprim të klasifikuar nga Prokurori si vepra penale e Lidhjes së kontratës së dëmshme. Për arsyet e njëjta ligjore siç është paraqitur më lart, akuza është hudhur. Vlen të theksohet se edhe në lidhje me këtë akuzë, Prokurori nuk ka paraqitur ankesë kundër vendimit të Kryetares së Trupit Gjykses.

9. Dyshimi i bazuar mirë për veprën penale të Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 4)

178. F.L., N.K. dhe S.T. akuzohen me veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në shkelej të nenit 339 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së së vjetër, e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vjet, në lidhje me nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerja) për F.L. dhe N.K. dhe me nenin 25 të KPK-së së vjetër (ndihma) për S.T. lexuar gjithashtu në lidhje me nenin 117.1 a. dhe d. të *Ligjit për Prokurimin Publik* dhe lexuar gjithashtu në lidhje me veprën penale në vijim të Marrjes së ryshfetit, siç është specifikuar në Pikën 5.
179. Prokurori pretendon se F.L., N.K. dhe S.T. kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare duke negociuar, premtuar, përkatësisht dhënien e tenderëve për ndërtimin e rrugëve, kompanisë ndërtimore *B.* në këmbim të ryshfetit të kërkuar. Tenderi është dhënë duke anashkaluar dhe manipuluar rregullat ligjore të prokurimit, në shkelje të nenit 6.2. të *Ligjit për Prokurimin Publik*, që ndalon favorizimin e një kompanie mbi të tjerat në çdo fazë të procedurës së prokurimit.

Parashtrësat e palëve

180. Mbrojtja e F.L. dhe N.K. paraqet se akuza e Keqpërdorimit apo autoritetit zyrtar duhet të hudhet, pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se ajo është kryer. Është argumentuar se edhe nëse ka pasur gabime procedurale në procedurën e tenderit, i pandehuri nuk ka patur ndërmend të shkelte ligjin.
181. Mbrojtja e S.T. paraqet se akuza duhet të hudhet sepse i pandehuri nuk është një person zyrtar, kështu që ai nuk mund të kryejë krimin si bashkë-kryerës. përveç kësaj, nuk ekziston asnjë provë që do të vërtetonte se ndonjë zyrtar i MTPT-së ka kërkuar apo marrë ryshfet në lidhje me procedurën e tenderit, e cila është subjekt i aktakuzës. Mbrojtja më tej nuk pajtohet me konkludimin e Prokurorit se ryshfetet e pretenduara ishin paguar në shkëmbim të dhënies së tenderit 08-006-511 kompanisë *B.*, ndërsa ky tender përfundimisht i është dhënë kompanisë *E.*
182. Prokurori nuk e ka adresuar në mënyrë specifike këtë argument në përgjigjen e tij ndaj kërkesës së paraqitur nga Mbrojtja. Ai ka mbështetur qëndrimin e tij se keqzotojnë prova të

mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se vepra penale është kryer nga të pandehurit.

Ligji i zbatueshëm

183. Neni 339 i KPK-së së vjetër siç është zbatuar nga Prokurori në Aktakuzë lexon, në pjesën përkatëse, si në vijim:

“(1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore përvete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkaktimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 EUR, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.”

184. Definicioni i një “personi zyrtar” është përcaktuar në nenin 107 (1) të KPK-së së vjetër, sipas të cilit personat në vijim duhet të trajtohen si zyrtar:

- Personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ publik;
- Personi i autorizuar në një organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit a ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligjin ushtron autoritet public dhe brenda këtij autoriteti ushtron detyra të posaçme;
- Personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj;
- Personi i cili është anëtar i personelit të zyrave të ndërlidhjes në Kosovë;
- Personi në një organizatë publike ndërkombëtare ose mbinacionale i cili njihet si zyrtar ose punonjës tjetër i kontraktuar sipas rregulloreve të personelit të organizatës së tillë;
- Gjykatësi, prokurori ose zyrtari tjetër në gjykatën ndërkombëtare që ushtron juridiksion në Kosovë.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

185. Kryetarja e Trupit Gjykses e konsideron të nevojshme të verifikojë gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimin e Prokurorit nëse F.L., N.K. dhe S.T. kanë kryer veprën penale të Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar. Provat e paraqitura nga Prokurori tregojnë se i pandehuri F.L. ka përdorur pozitën e tij brenda Ministrisë për të ndikuar në procedurat e tenderit. Për më tepër, i pandehuri S.T. në cilësinë e rojës personale të F.L., ka përdorur pozitën e tij për t'u ndërlidhur me kompanitë dhe lidhjen e tij me F.L. për të ndikuar në procedurat e tenderit. Kryetarja e Trupit Gjykses pohon se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se është kryer vepra penale. Kjo mbështetet nga provat e shumta të paraqitura nga Prokurori, siç janë telekomunikimet e përgjuara, dosjet e procedurave të tenderit, reportet e ekspertëve në mënyrën në të cilën janë kryer procedurat e tenderit, dhe deklaratat e dëshmitarëve në lidhje me këshillimet dhe vlerësimet e komisionit brenda MTPT që do t'i jepnin tenderin kompanisë fituese. Vet fakti se F.L. si Ministër nuk ishte i autorizuar nga ligji që të merrte pjesë drejtpërdrejtë në procedurën e prokurimit, nuk e përjashton *exclude per se* ndërhyrjen potenciale të tij në të. gjatë shqyrtimit gjyqësor duhet të verifikohet nëse ai ka përdorur pozitën e tij politike dhe personale për të ndikuar në rezultatet e procedurave të tenderit të kryer nga Ministria që ka udhëhequr ai.
186. Kryetarja e Trupit Gjykses pajtohet me Mbrojtjen e S.T. që argumento se i pandehuri nuk ishte një person zyrtar në kuptim të nenit 107 të KPK-së së vjetër dhe, prandaj, ai mund të konsiderohet përgjegjës penalisht si bashkë-kryerës për një veprë penale në shkelje të nenit 339 të KPK-së së vjetër. Parimi që të gjithë bashkë-kryerësit duhet të plotësojnë cilësinë e kryerësit të veprës siç është parashikuar me ligjin penal, është esenciale.³⁶ Vepra penale e Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, kërkon që kryerësi i veprës penale të jetë një "person zyrtar". Nuk ka asnjë bazë për të supozuar se i pandehuri S.T. në cilësinë e tij të rojës personale/shoferit të F.L. të ishte një person zyrtar.
187. Kryetarja e Trupit Gjykses është e mendimit se sa i përket të pandehurit S.T. mënyra e detyrimit të ndihmës do të merret parasysh në vend të bashkë-kryerjes, siç mund të reflektojë më mirë rrethanat faktike të paraqitura në Aktakuzë. Gjetja se i pandehuri ka kryer një veprë penale përmes asistimit të kryerësit, i cili është një person zyrtar nuk kërkon që bashkëfajëtori,

³⁶ Shih L. Laszarevic, Komentimi i Kodit Penal të ish Republikës së Jugosllavisë, edicioni 5, viti 1995, neni 22, para. 1: "[Bashkëpunimi] ekziston kur disa persona të cilët përmbushin kërkesat që kanë të bëjnë me akterin kryesor të një veprë të veçantë dhe së bashku pajtohen të veprojnë si bashkëpunëtorë" [theksim i shtuar].

d.m.th. personi i cili ndihmon, të ndajë të njëjtin cilësim si kryesori. Një arsyetim i tillë mbështetet nga dispozita e nenit 36 (3) të KPK-së së re, në pjesën përkatëse lexon si në vijim:

“(…)Nëse rrethanat personale të cilat ndërlidhen me kryesinkanë ndikim në zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe këto rrethana konstituojnë element tëveprës penale, bashkëkryesi, shtytësi ose ndihmësi është përgjegjës për dënimin e paraparë për veprë penale kur ai ka ditur për këtë rrethanë, edhe nëse nuk ka pasur lidhshmëri me të.”

188. Edhe pse KPK e vjetër nuk përman një dispozitë të njëjtë, sidoqoftë Kryetarja e Trupit Gjykses është e mendimit se i njëjti parim sa i përket qëllimit të përgjegjësisë së një ndihmësi mund të interpretohet nga neni 1 i KPK-së së vjetër, bashkuar me definicionin e ndihmës, paraparë në nenin 25 (*“kushdo që me dashje e ndihmon tjetrin të kryejë veprë penale (...)”*).

189. Prandaj, Kryetarja e Trupit Gjykses gjen se, varësisht nga rezultatet e procedurës së shqyrtimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, mund të bëhet ri-klasifikimi mënyra e përgjegjësisë nga bashkë-kryerja në ndihmë në lidhje me të pandehurin S.T. Kompetenca për të ri-klasifikuar rezulton nga neni 253 (2) i KPP-së, që parasheh se *“kryetari i trupit gjykses nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë”*.

10. Dyshimi i bazuar mirë kundër F.L., N.K. dhe S.T. për veprën penale të Marrjes së ryshfetit (Pika 5); dhe kundër A.A.t dhe B.D. për veprën penale të Dhënies së ryshfetit (Pika 6).

190. Kryetarja e Trupit Gjykses e konsideron të arsyeshme për të vlerësuar bashkërisht akuzat e Marrjes së ryshfetit (kundër F.L., N.K. dhe S.T.) dhe të Dhënies së ryshfetit (kundër B.D. dhe A.A.).

191. Prokurori pretendon se në vitin 2008 në Kosovë, F.L. në pozitën e tij zyrtare si Ministër i MTPT-së, N.K. në detyrën e tij zyrtare si Shef i Prokurimit në MTPT; dhe ndihmuar nga S.T., kanë kërkuar për pagesën e fondeve financiare në shkëmbim të dhënies së tenderit kompanisë së ndërtimit të rrugëve B.

Parashtrësas e palëve

192. Sa i përket akuzave të Marrjes dhe Dhënies së ryshfetit, Mbrojtja kërkon që të hudhen ato për shkak të mungesës së provave për dyshimin e bazuar mirë se janë kryer veprat penale.
193. Mbrojtja e S.T. përveç kësaj parashton se i pandehuri nuk ka mundur ta kryente veprën penale të Marrjes së ryshfetit, pasi që ai nuk është një person zyrtar në kuptimin e Kodit Penal.
194. Prokurori në përgjigjen e tij ndaj parashtresave të Mbrojtjes merr qëndrimin se ekzistojnë prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë kundër të pandehurve për veprat penale.

Ligji i zbatueshëm

195. Neni 343 i KPK-së së vjetër përcakton elementet e nevojshme të veprës penale të marrjes së ryshfetit. Në pajtim me këtë, kjo vepër penale kryhet nga personi zyrtar i cili kërkon ose merr dhuratë a përfitim tjetër për vete ose personin tjetër ose që pranon premtimin për dhuratë ose për ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo një veprim tjetër

- të cilin ai nuk duhet ta kryejë ose të mos e kryej një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai duhet ose ka mundur ta kryejë (paragrafi 1);
- të cilin ai është dashur ta kryejë ose të mos e kryejë një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë (paragrafi 2).

Si rezultat nga paragrafi 3 kjo vepër penale mund të kryhet gjithashtu nga personi zyrtar i cili pas kryerjes ose moskryerjes së një veprimi nga paragrafi 1 dhe 2, kërkon apo pranon dhurata ose ndonjë përfitim për vete apo për personin tjetër në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e tillë.

196. Vepra penale e Dhënies së ryshfetit është definuar në nenin 344 të KPK-së së vjetër, që parasheh se është kryer nga një person i cili jep ose premtim se do t'i jep dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar për veprimet e kryerjes apo moskryerjes, siç është përmendur më lart.

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

197. Pretendimet e prokurorit se janë paguar ryshfetet është bazuar kryesisht në përgjimin e telekomunikimeve nga telefoni i të pandehurit A.A. Në veçanti, Prokuroria mbështetet në

një telekomunikim të përgjuar në mes të A.A. dhe S.T. më 22 shkurt 2008, me çrast janë bërë deklaratat në vijim:

“S.T.: Po, edhe një gjë, ata do të... diçka, zakonisht ata do të marrin diçka.

A.A.: Aha, aha.

S.T.: Njëri është 900 e diçka.

A.A.: Dhe është Bajrushit?

S.T.: Jo, jo, jo më ai, ai ishte më i larti për të nënshkruar gjëra.”³⁷

Më 4 mars 2008, S.T. i tha A.A.t se “ne nuk do të lëshojmë atë pa marrë diçka”.³⁸

198. Përveç kësaj, Prokuroria mbështetet në telekomunikimet e përgjuara që janë mbledhur pas 5 prillit 2008. Siç është sqaruar më lart, këto telekomunikime të përgjuara janë marrë në mënyrë të paligjshme pasi që nuk është lëshuar asnjë urdhër gjykate për të autorizuar masën e fshehtë të vazhimit të përgjimit pas datës 5 prill 2008. Si pasojë, një provë e tillë është e papranueshme dhe nuk mund të merret në konsideratë gjatë vlerësimit nëse ekziston dyshimi i bazuar mirë se ryshfetet e pretenduara janë ofruara dhe pranuar nga të pandehurit. Prokuroria ka bazuar gjithashtu pretendimin e saj në dëshminë e të pandehurit A.A. në procedurë paraprake, të cilën Kryetarja e Trupit Gjykses e ka gjetur të papranueshme për shkak të rolit udhëheqës dhe kontrollit të përgjithshëm që kishte Zyrtari Ligjor nga PSRK gjatë intervistës.

199. Megjithëse është i vlefshëm argumenti se kjo provë duhet të konsiderohet si tërësi, edhe gjatë interpretimit të provave para Gjykatës, Prokuroria nuk paraqiti ndonjë provë të ligjshme se i pandehuri A.A. u takua apo pati kontakt direkt me të pandehurin F.L.. Në të njëjtën mënyrë, asnjë provë e ligjshme nuk është paraqitur për të mbështetur pretendimet se janë ofruar, paguar apo negociuar ryshfetet. E vetmja lidhje që “normalisht, ata do të marrin diçka” ose se “ne nuk do të lëshojmë atë pa marrë diçka”, sipas mendimit të Kryetares së Trupit Gjykses, nuk arrin pragun e dyshimit të bazuar mirë, që kërkohet sipas nenit 253 (1.4) të KPP-së për të konfirmuar veprën penale të Marrjes së ryshfetit.

200. Prandaj, Kryetarja e Trupit Gjykses vendos të hudh akuzat e Marrjes së ryshfetit (kundër F.L., N.K. dhe S.T.) dhe të Dhënies së ryshfetit kundër A.A. dhe B.D..

³⁷ Dosja 11, pp. 86-88.

³⁸ Dosja 11, p. 198.

11. Dyshimi i bazuar mirë për veprën penale të Keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi kundër A.A. dhe B.D. (Pika 6)

201. Prokuroria paraqet se nga 8 shkurti 2008 deri më 25 prill 2008, në lidhje me procesin e tenderit 08-006-511, rajoni i Ferizajt, dhe nga 23 prilli 2008 deri më 3 qershor 2008, për tenderin MTPT 08/073/521, B.D., në cilësinë e pronarit të kompanisë B. ka shkelur ndjeshëm rregullat e aktivitetit të biznesit me vetëdije dhe qëllimisht duke përdorur bashkë të pandehurin A.A. si “ndërmjetës” për të manipuluar procesin e tenderit, duke e kontaktuar S.T. dhe duke i përcjellë F.L. porosi relevante të tenderit. Pretendimet e Prokurorisë bazohen në provat e dokumentuara, siç janë raporti i vlerësimit të ofertës dhe rekomandimi për dhënien e kontratës, ofertat e paraqitura nga kompanitë B. dhe E. raportet e ekspertëve mbi procedurat e dhënies së kontratës, dosja e tenderit, dhe telekomunikimet e përgjuara nga rasti “Shpërthimi në Bulevardin Clinton” për periudhën nga 6 shkurti 2008 deri më 5 prill 2008. Sjellja e tyre është cilësuar nga Prokurori si Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi.

Parashtresat e palëve

202. Mbrojtja kërkon që kjo pikë të hudhet, duke argumentuar, *në mes tjerash*, se: (i) se përshkrimi i fakteve në Aktakuzë në lidhje me Pikën 6 i referohet kompanisë E. në vend të kompanisë B. (ii) A.A. nuk është përfaqësues i kompanisë B.; (iii) dispozitivi i Aktakuzës nuk përfshin ndonjë element të veprave penale; (iv) nuk ka asnjë provë për të mbështetur argumentin e Prokurorisë së 7.3% e uljes së çmimit duke e dyshimtë;

203. Prokuroria kundërshton parashtresën e Mbrojtjes, duke përmendur se argumentet e Mbrojtjes janë pohime dhe konkludime të pasqaruara që mbrojtja nuk ka arritur të specifikojë bazat e argumenteve të saj, duke e bërë të pamundur për Prokurorinë që të përgjigjet në parashtresë.

Ligji i zbatueshëm

204. Neni 236 i KPK-së së vjetër parasheh definicionin në vijim të veprës penale të Keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi:

“Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të

kundërligjshme për organizatën e biznesit ose personin juridik në të cilin është i punësuar apo organizatën tjetër të biznesit ose për personin juridik:

- 1) krijon apo mban fonde të palejuara në Kosovë ose në çfarëdo juridiksioni tjetër;*
- 2) me përpilimin e dokumenteve me përmbajtje të rrejshme, me bilance të rreme, me vlerësime apo inventarizim apo me prezentim tjetër të rremë a me fshehjen e fakteve në mënyrë të rreme e prezenton lëvizjen e mjeteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e biznesit apo në personin juridik gjatë vendimmarrjes lidhur me punët e qeverisjes;*
- 3) nuk i paguan mjetet nga detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera fiskale në Kosovë të përcaktuara me ligj;*
- 4) mjetet me të cilat disponon i shfrytëzon në kundërshtim me qëllimin e tyre të Paraparë; ose*
- 5) në mënyrë tjetër e cenon rëndë ligjin apo rregullat e afarizmit lidhur me rregullimin, përdorimin apo administrimin e pasurisë."*

205. Gjykata e Apelit ka sqaruar formulimi i "ligjit dhe rregullave të aktivitetit të biznesit që ka të bëjë me dispozicionin, përdorimin ose menaxhimin e pronës" duhet të kuptohet si "shkelje të çdo ligji, me kusht se përmbushja e të gjitha elementeve tjera, do të rezultojë në këtë vepër penale, ndërsa vetëm shkeljet e rregullave të aktivitetit të biznesit në lidhje me dispozicionin, përdorimin ose menaxhimin e pronës do të shkaktojnë përgjegjësinë penale".³⁹

206. Gjykata e Apelit ka nënvizuar më tej se në përputhje me formulimin e dispozitës, "jo të gjitha por vetëm shkeljet e rënda shkaktojnë përgjegjësi penale. Prandaj, duhet të sqarohet nëse shkelja e pretenduar është e natyrës së tillë serioze. Më fjaë të tjera, Gjykata duhet të sqarojë kutpimin e termit "shkelje e rëndë" siç përdoret në këtë dispozitë".⁴⁰

Gjetjet e Kryetares së Trupit Gjykses

207. Nga analizat e akuzës dhe materialit të siguruar nga Prokuroria rezulton se të pandehurit A.A. dhe B.D. ishin duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin në procesin e përgatitjes së tenderëve për kontratën e ndërtimit të rrugëve me MTPT. Materialet e përgjuara tregojnë se A.A. po lobonte për kompaninë B. në pronësi të B.D., në mënyrë që t'i ndihmonte atij të fitonte

³⁹ Gjykata e Apelit, PN 577/2013 (MTPT 1), Aktvendimi, 10 dhjetor 2013, para. 192.

⁴⁰ Ibid, para. 193

procedurën e tenderit. Ai pretendohet të ketë patur kontakte me të pandehurin S.T. i cili supozohet se ishte personi kontaktues në mes të kompanisë dhe njerëzve në MTPT duke patur ndikim në procedurën e prokurimit.

208. Kryetarja e Trupit Gjykes pohon se përshkrimi i rrethanave faktike që arsyeton akuzën e Keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi kundër B.D. dhe A.A. nuk përmban të gjitha elementet e nevojshme të veprës penale siç parashihet në nenin 236 paragrafin 1, nënparagrafët 4 dhe 5 të KPK-së së vjetër.

209. Ajo që duhet të theksohet, sa i përket A.A.t, nuk ka asnjë përshkrim në Aktakuzë sa i përket rrethanave personale që përbëjnë elementin e krimit, d.m.th. të jesh *“personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik”*. Nga Aktakuza dhe provat e paraqitura nga Prokurori, rezulton se i pandehuri A.A. ka bashkëpunuar vetëm me kompaninë B. dhe në baza *ad hoc*; ai nuk ka qenë një i punësuar i kompanisë, e as që ka patur ndonjë kontratë për menaxhment apo të ngjashme.

210. Përshkrimi i akuzës së paraqitur nga Prokurori tregon se mënyra tjetër që A.A. ka kryer *“shkelje të rëndë të ligjit apo të rregullave të aktivitetit të biznesit”* ishte se ai kishte kontakte me S.T. në emër të kompanisë B. dhe supozohet t’i ketë përcjellur F.L., porosi që lidheshin me tenderin përkatës. Kryetarja e Trupit Gjykes Kryetarja e Trupit Gjykes nuk pajtohet me vlerësimin e Prokurorit se ky lloj aktiviteti përbën veprë penale. Kjo lloj sjellje është mjaft tipike në marrëdhëniet e biznesit, dhe mund të trajtohet si lobim, që është një aktivitet i përpjekjes për të bindur dikë në autoritet, për të mbështetur një organizatë biznesi për arritjen e epërsisë, psh. Përmes fitimit të një kontrate në procedurës publike të prokurimit. Përderisa ky aktivitet nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar me ligjin ose rregullat e aktivitetit të biznesit, nuk mund të jetë një bazë për një ve[ër penale të Keqpërdorimit të autorizimit në ekonomi.

211. Edhe nëse Kryetarja e Trupit Gjykes të jetë pajtuar me Prokurorin se A.A. dhe B.D. kanë shkelur rëndë ligjin dhe rregullat e aktivitetit të biznesit, nuk do të ishte e mjaftueshme të gjendej se vepra penale e keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi, siç ceket në nenin 236 (1.5) të KPK-së vjetër, është kryer gjoja nga ata. Elementi i nevojshëm i saj është ekzistimi i lidhjes në mes të një shkelje të tillë dhe dispozicioni, përdorimi apo menaxhimi i pronës. Në fakt, Prokurori përgjegjës nuk ka përmendur fare këtë element të veprës penale. Kryetarja e Trupit Gjykes nuk gjen ndonjë lidhje në mes të shkeljeve të pretenduara të ligjit ose rregullave të biznesit dhe pronës.

212. Prokurori e klasifikoi akuzën e keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi kundër B.D. dhe A.A.t, gjithashtu si një shkelje të nenit 236 (1.4) të KPK-së vjetër. Megjithatë, pretendimet faktike për të arsyetuar këtë akuzë të paraqitur në aktakuzë nuk përmbajnë elementet e nevojshme të veprës penale siç është përshkruar me ligj. Prokurori nuk ka sqaruar fare se çfarë mjetesh në dispozicion të të pandehurit janë përdorur në kundërshtim me synimin e tyre të paraparë; ai nuk e ka shqyrtuar këtë çështje fare.

213. Duke patur parasysh atë që u tha më lart, Kryetarja e Trupit Gjykes gjen se nuk ka asnjë provë të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se vepra penale e Keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi është kryer nga të pandehurit A.A. dhe B.D.. Prandaj, akuza hudhet poshtë.

12. Përmbledhje

214. Pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se veprat penale janë kryer, hudhen akuzat e mëposhtme të aktakuzës:

- Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 2);
- Lidhja e kontratës së dëmshme kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 3),
- Marrja e ryshfetit kundër F.L., N.K. dhe S.T. (Pika 5),
- Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi dhe Dhënia e ryshfetit kundër A.A.t dhe B.D. (Pika 6).

215. Nuk hudhen akuzat e mëposhtme të aktakuzës:

- Kundër F.L.t, N.K.t dhe S.T.: Krimi i organizuar, në shkelje të nenit 274, paragrafi 3 i KPK-së së vjetër, lexuar me paragrafin 1 të KPK-së së vjetër dhe e dënueshme me gjobë deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet, lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkë-kryerja) (Pika 1);
- Kundër F.L.t dhe N.K.t: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në shkelje të nenit 442 të KPK-së së re, e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vjet; lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkë-kryerja); dhe përveç kësaj lexuar së bashku me nenin 117.1 a dhe d të Ligjit për Prokurimin Publik (Pika 4).

Prishtinë, 29 maj 2014.

Anna Adamska-Gallant,

Kryetare e Trupit Gjykses

MJETI LIGJOR: Kundër këtij Aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës. Ankesa duhet të paraqitet brenda pesë (5) ditëve nga dorëzimi i vendimit me shkrim (nenet 249 (6), 250 (4) të KPP-së).